

1 E mërkurë, 2 tetor 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, paraqisni lëndën ju lutem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vijojmë
12 sot me dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes së z. Thaçi 1DW-
13 004.

14 Dje, i kërkoja ZPS-së të më jepte listën e provave
15 materiale me shkrim, i morët të gjithë numrat përkatës me
16 postën elektronike besoj. Posta elektronike erdhi në fakt në 2
17 tetor në orën 8.09 të mëngjesit.

18 Fillimisht, ka ndonjë kundërshtim lidhur me dokumentet e
19 renditura në të?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
22 kundërshtime nga palët. Atëherë lista e dorëzuar nga
23 Prokuroria do të pranohet si provë gjyqësore.

24 I lutem Sekretarit të seancës të na thotë më vonë se
25 çfarë numrash do t'ju japi, apo doni ta bëni tani?

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Tani.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
4 këshillohen]

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë ju faleminderit.

6 Për materialin SITF00001529 deri në 00001871, faqet
7 SITF00001531, SITF00001522, SITF00001533 dhe SITF00001525 do
8 t'i bashkëngjiten provës materiale P00743.2.

9 ERN 068429 deri në 0683434 do të marrë numrin e provës
10 materiale P04506.

11 Ndërsa materialet që i përkasin një grupi më të madh me
12 numër 052690, 052841, veçanërisht faqet 0526 - më falni - do e
13 them dhe një herë. Pra faqet 052690, 052694 dhe 052746 deri në
14 052749 do të marrin numrin e provës materiale P04507.

15 Dhe ju lutem më thoni çfarë klasifikimi do t'ju japim.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Këto mund të jenë dokumente
17 publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Riklasifikojini si dokumente publike të gjitha.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Më lejoni t'ju bëj një sqarim, ju
21 lutem. Edhe prova materiale P04503 mund të klasifikohet si
22 publike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Klasifikoheni si publike.

25 Sekretare e seancës, tani mund të sillni dëshmitarin në

1 sallë.

2 Për procesverbal, të akuzuarit janë të gjithë të
3 pranishëm në sallën e gjyqit.

4 Dhe sa kohë mendoni se ju nevojitet, z. Misetic?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj se do përfundoj rreth orës
6 10.00.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

11 Do të vazhdojmë sot me dëshminë tuaj.

12 Ju rikujtoj t'u përgjigjeni pyetjeve qartë, me fjali të
13 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkonit që
14 pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që
15 ta sqarojmë. Gjithashtu, mos harroni të na thoni bazën lidhur
16 me faktet njohuritë për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

17 Jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën sikurse vetë
18 e cituat përmes betimit solemn.

19 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
20 se t'i përgjigjeni pyetjes dhe flisni ngadalë për përkthyesit.
21 Dhe në çdo moment që keni nevojë për pushim ju lutem na vini
22 në dijeni dhe do të bëjmë organizimin përkatës.

23 Fjalën e ka ende z. Misetic. Dëgjojeni me vëmendje.

24 Z. Misetic, fjala është për ju.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 4

1 DËSHMITARI: JAMES COVEY [Vijon]

2 Pyetje vijuese nga z. Misetic: [Vazhdim]

3 Z. MISETIC: [Përkthim]

4 PY. Mirëmëngjes, Z. Covey.

5 PË. Mirëmëngjesi.

6 PY. Do të doja të fillonim me disa pyetje që ju bëri dje
7 Prokurorja lidhur me marrëdhënien e z. Thaçi me UÇK-në. Lidhur
8 me këtë iu tregoi dhe një pjesë të librit të Gjeneralit
9 Jackson për një takim që ka pasur ai me z. Thaçi përpara
10 takimit me Gjeneralin Clark që keni diskutuar në dëshminë
11 tuaj. A ju kujtohen këto pyetje?

12 PË. Po.

13 PY. Do shohim dhe një herë deklaratën tuaj ju lutem.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë i lutem Sekretarisë të
15 vendosi në ekran deklaratën e dëshmitarit. Shkojmë në faqen 12
16 të dokumentit, ju lutem, për të parë paragrafin 65. Më poshtë.

17 PY. Ju keni thënë kështu:

18 "Unë e kisha të qartë që lidhja e z. Thaçi me veteranët e
19 vjetër që kanë qenë në betejat e UÇK-së ishte në fiqe të perit
20 dhe ishte shumë i kujdesshëm që të mos ta tërhiqte shumë perin
21 sepse mund të këputej. Ishte diçka e rrallë, po ndonjëherë
22 dukej sikur përpiqej të përfaqësonte interesat e UÇK-së, të
23 paktën retorikisht ose të shërbente si pikë ndërlidhjeje."

24 Keni dhënë dhe një shembull këtu, "ku z. Thaçi ka thënë
25 që UÇK-ja synonte të formonte një ushtri në përfundim të

1 procesit të demilitarizimit".

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani shkojmë në paragrafin 81, që
3 është në faqen 15 të dokumentit.

4 PY. Këtu keni thënë kështu:

5 "Nga konstatimet e mia dola në përfundimin se z. Thaçi
6 kishte ambicien dhe objektivin të bëhej politikan dhe
7 udhëheqës në Kosovë dhe ai e dinte se duhej të bashkëpunonte
8 me UNMIK-un për ta realizuar këtë. Ndonëse fillimisht shërbeu
9 si një urë lidhëse për interesat e UÇK-së, vlen të thuhet se
10 këto raste shërbyen sepse ai përfundimisht përfundoi,
11 domethënë, pati një qëndrim legjitim dhe i shërbeu të drejtave
12 të tij."

13 Më pas keni thënë, shpresoj të trajtojmë disa nga rastet
14 se si z. Thaçi dukej se advokonte në emër të atyre që ishin
15 persona me interes apo kryesorë në UÇK."

16 Tani pyetja ime është kjo: A mund të na jepni disa nga
17 këto rastet konkrete që i keni thënë dje?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E kundërshtoj. Kjo është përtej
19 fushëveprimit tim. Unë nuk diskutova konkretisht këtë pjesë të
20 deklaratës me dëshmitarin sa i takon atij që paska qenë urë
21 lidhëse. Nëse lejohet avokati të bëjë pyetje të këtij lloji,
22 atëherë dhe unë do bëjë pyetje të mëtutjeshme.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj. Unë do t'i bëj
24 pyetjet sepse Prokuroria konkretisht ka diskutuar takimin e z.
25 Thaçi me Gjeneralin Jackson.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
2 rrëzohet.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, kjo është diçka më vete.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mora
5 vendimin dhe e kundërshtova kundërshtimin tuaj.

6 Vijoni.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Besoj se dje apo të paktën këto dy
8 ditë që kam qenë këtu, kemi parë një dokument që z. Thaçi ia
9 kishte dërguar Bernard Kouchner ku kërkonte armë për disa
10 persona të UÇK-së, ish-anëtarë të UÇK-së dhe ne e dinim që në
11 atë kohë, të paktën sipas mendimit tonë, kjo nuk duhet të
12 ndodhte, po ne e kuptuam që ai ishte një urë lidhëse, kjo
13 ishte përshtypja jonë, ai po kryente detyrën që ia kishin
14 kërkuar të tjerët. Po përpigjej të mbante marrëdhënie të mirë
15 me persona që donte t'i mbronte dhe nuk donte t'i mërzhiste
16 këta persona.

17 Pra, ne menduam se pikërisht kjo sjellje u shfaq disa
18 herë.

19 Dhe më duhet të shtoj, ky është gjykimi im, do të shtoj
20 dhe episodin që është përshkruar në librin e Mike Jackson, që
21 ka qenë shumë kohë më pas. Z. Thaçi nuk kishte marrë shumë
22 pjesë në negociatat mes KFOR-it dhe udhëheqësve të lëvizjes së
23 UÇK-së. Dhe nuk më befason që ai e ndiente nevojën që ai të
24 bënte të qartë përkrahjen e tij të fortë për udhëheqjen e UÇK-
25 së. A do të ishte e suksesshme apo jo, kjo është diçka më vete

1 asokohe, unë thjesht mund të hamendësoj. Por kërkesa e tij që
2 Jackson të shkonte në qytet ta takonte asokohe ishte shumë
3 serioze, por ishte dhe për të qeshur njëkohësisht. Po ky ishte
4 një djalë i ri që po përpigjej të ishte i suksesshëm, ishte një
5 situatë në të cilën ai s'kishte fare përvojë, ne nuk u
6 befasuam aspak për këtë. Ai përpigjej të pozicionohej pra.

7 Dhe duhet të shtoj dhe për një histori, që nuk e kam
8 ditur asokohe, një pasur një raport që ai mbante municione në
9 male. Unë s'kam parë ndonjë provë që të ketë ndodhur kjo
10 rregullisht, po ky ishte një djalë i ri, ambicioz, e bëri këtë
11 një herë sepse donte të arrinte diku, sigurisht që është
12 normale ta ketë bërë këtë sepse ai kërkonte të çimentonte
13 pozicionin e vet.

14 Nuk mendoj se kjo cenon gjykimin tonë apo ndryshon
15 gjykimin tonë sa i takon marrëdhënies që ka pasur ai me
16 komandantët e terrenit të UÇK-së dhe as të kontradikton gjërat
17 që ka thënë publikisht, që janë publike, ku ka advokuar në
18 fakt, për të mos pasur akte dhune dhe të mbroheshin pakicat.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Faleminderit.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do të flas për një temë
22 tjetër. Me kërkesë të ofruesit të informacionit sipas
23 rregullës 107, kjo duhet të trajtohet në seancë private.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] kalojmë në
25 seancë private.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 8

- 1 [Seancë private]
- 2 [Seancë private teksti i fshirë]
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 9

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 10

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 Faleminderit.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Z. Covey, dje iu tregoi Prokurorja video ku shfaqej z.

22 Thaçi dhe z. Çeku ku kanë marrë pjesë në disa organizime ku ka

23 pasur të pranishëm anëtarë apo ish-anëtarë të UÇK-së. ju

24 kujtohen këto video?

25 PË. Po.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 11

1 PY. Tani do të doja të shikonim paragrafin 72 të deklaratës
2 suaj.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani shkojmë në provën materiale
4 1D00390, në faqen 13.

5 PY. Në paragrafin 72, thoni:

6 "Instinktet dhe pretendimi i z. Thaçi se kishte
7 kompetencë mund të ketë qenë e dobishme nga pikëpamja politike
8 përpara audiencave kosovare por u keqkuptuam prej disa
9 personave nga komuniteti i drejtave të njeriut, përfshirë
10 specialistë të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u, që në
11 mënyrë të padrejtë dolën në përfundimin se z. Thaçi ishte
12 udhëheqës se kishte kompetenca të kontrollonte dhunën që
13 kryhej nga elementë që kishin qenë gjithmonë të decentralizuar
14 (dhe tani në) ish-UÇK. Për të gjithë ne që ishim atje ishte e
15 qartë që z. Thaçi thjesht kishte ambicie dhe nuk kishte
16 influencë të vërtetë ndaj UÇK-së."

17 Pra, videot që ju treguan dje ku shfaqej z. Thaçi në këto
18 grupime me ish-anëtarë e UÇK-së, ua ndryshon mendimin e asaj
19 që keni thënë në paragrafin 72?

20 PË. Nuk e ndryshon pikëpamjen time. Unë e konsideroj njësoj,
21 njësoj siç e kam përshkruar dhe kur e kam ilustruar përmes
22 incidenteve të tjera. Ai thjesht përpigëj të pozicionohej, të
23 fitonte kredibilitet. Këtë bëjnë politikanët ambiciozë.
24 Asociohen me elementë që mendojnë që do ju shërbejnë
25 interesave të tyre kanë apo nuk kanë influencë në realitet apo

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 12

1 jo.

2 PY. Faleminderit. Tani do të flasim për një temë tjetër. Në
3 transkriptin e ditës së djeshme, në faqen 116, ju thatë që i
4 dhatë Gjeneralit Çeku një tekst me disa pika për të diskutuar.
5 Dhe thatë që ishin pika diskutimi të ndryshme nga ato që ishin
6 përgatitur për z. Thaçi.

7 Tani ju lutem na thoni cilat ishin pikat për diskutim me
8 Gjeneralin Çeku?

9 PË. Nuk mendoj, nuk besoj se mund t'ua them kështu përmendsh,
10 por ka një dokument ku përmbahen të gjitha pikat për diskutim
11 që kishim përgatitur nga Bernard Kouchner si për z. Thaçi dhe
12 pika të tjera për diskutim që do të përdorja unë me Gjeneralin
13 Çeku.

14 PY. Në faqen e transkriptit 116, rreshtat 24 dhe 25, ju
15 thoni:

16 "Unë theksova me disa, vura re me shqetësim që ju nuk
17 deshët të diskutonit pikat për diskutim që i dhanë z. Çeku."

18 A ka diçka që doni të shtoni, z. Dëshmitar, që nuk patët
19 mundësi ta thoni dje?

20 PË. Kishte një dallim thelbësor mes pikave për diskutim, i
21 cili ishte se në atë kohë Gjenerali Çeku ishte komandanti i
22 TMK-së teknikisht. Ishte ende e paorganizuar, ishte në krijim
23 e sipër TMK-ja dhe Gjeneralit Çeku kur i bëra pak presion që
24 të ndërmernte sisa veprime ma rikujtoj këtë gjë që ishte ende
25 në formim e sipër TMK-ja. Po, në atë pikë, z. Thaçi nuk kishte

1 asnjë lloj roli në TMK dhe për këtë aktivitet nuk donim të
2 jepnim aspak atij përshtypjen se ne besonim se ai kishte rol
3 në lidhje me TMK-në.

4 Kjo nuk ka lidhje me influencën ndaj ish-anëtarëve, ish-
5 udhëheqësve të UÇK-së. E kemi diskutuar këtë temë më vete. Ky
6 ishte një formalitet në vetvete. Ndonëse Nju Jorku priste që
7 ne t'i përcillnim të njëjtën porosi të dy këtyre udhëheqësve,
8 po ne po ashtu e kishim të qartë që Nju Jorku ishte shumë
9 kundër TMK-së. Iu desh shumë kohë atyre në Nju Jork të
10 kuptonin, në fakt, që ky ishte një veprim me shumë mend, ishte
11 një veprim i zgjuar. Ne menduam se nuk ishte me vend që t'u
12 përcillnim të njëjtën porosi si z. Thaçi dhe z. Çeku.

13 PY. Po. Dhe dje ju thatë, dhe kjo është reflektuar në
14 transkript në faqen 111, rreshti 9, ju thatë pra, kur keni
15 folur për demarshin me Prokurorinë, ju thatë, "ka një kontekst
16 për këtë". Ky është konteksti?

17 PË. Po, ky ishte konteksti. Ky ishte historiku.

18 PY. Do të shohim një dokument tjetër që ua tregoi Prokurorja
19 dje.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Bëhet fjalë për dokumentin P04127.

21 PY. Ka datën 20 shtator 1999 dhe ua treguan dje, është raport
22 javor lidhur me situatën.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen 4. Shkojmë tek
24 fundi i faqes ku thuhet "koment".

25 PY. Këtë pjesë ua treguan dje dhe ua lexoi Prokurorja. Do ta

1 bëj dhe unë. Thuhet:

2 "Përfundimi i 'marrëveshjes' angazhuese na çon në dy
3 dilema. Së pari, personat lokalë të asociuar me 'Qeverinë e
4 Përkohshme' kanë filluar të jenë gjithnjë e më të egër. Mesa
5 duket me mbështetjen e Hashim Thaçit përmes deklaratave për
6 shtyp nga selia e OKB-së në Nju Jork."

7 Shkojmë ku thuhet "Nga ana tjetër ..."

8 "Nga ana tjetër, disa persona në Prizren duket sikur janë
9 të përgatitur që të dalin publikisht për të kundërshtuar,
10 domethënë, të bëjnë të qarta kundërshtimet e tyre sa i takon
11 komunitetit politikanë me represion dhe terror 'kundër ish-
12 kolaboracionistëve' (gjithmonë të akuzuar, por që asnjëherë
13 nuk është vërtetuar) se kanë qenë pjesë e regjimit jugosllav."

14 A ju kujtohet ky paragraf që dje?

15 PË. Po.

16 PY. Gjatë pyetjeve dhe përgjigjeve me Prokuroren ditën e
17 djeshme, dhe kjo është reflektuar në transkript në faqen 97,
18 ajo ju pyeti:

19 "A ju kujtohet asokohe që ju informuan për këto zhvillime
20 në komuna?"

21 Dhe ju u përgjigjët, thatë:

22 "Besoj se rreth kësaj kohe kemi marrë raporte shumë të
23 ngjashme, nuk mund të flas lidhur me këtë dokument konkret,
24 megjithatë ekzistonte një shqetësim asokohe. Megjithatë, është
25 mirë që ta vendosim në kontekst."

1 Tani unë dua t'ju jap mundësinë që ju ta vendosni
2 situatën në kontekst, nëse keni diçka për të thënë.
3 PË. Përmenda pak më herët përpjekjet në përgjithësi që janë
4 bërë, lidhur me përpjekjet në përgjithësi që janë bërë për të
5 zbatuar, për të realizuar misionin, paradoksi është ky, ne na
6 thanë që kanë ndodhur akte të shëmtuara në terren. Dhe
7 ekzistonte dhe dëshira në misionin tonë që ne të
8 kundërpërgjigjeshim menjëherë, në mënyrë vendimtare, të
9 silleshim sikur ishim ndonjë stacion zjarrfikëse që të fiknim
10 zjarret. Ne nuk i kishim burimet për ta bërë këtë. Dhe në të
11 njëjtën kohë, ne e dinim se deri në momentin që do të merrnim
12 burimet nuk kishim mundësi t'i demonstrojmë këtij populli që
13 paqja që po ia vilnin frytet paqes dhe se duhet të ndiqnin
14 rrugën që u tregonte UNMIK-u dhe do të shpërbleheni për këtë
15 nga pikëpamja morale, sociale dhe politike. Kjo është
16 gjithmonë e vështirë për një organizatë paqeruajtëse.

17 Kjo ishte një situatë shumë acaruese, shumë e vështirë si
18 për ne, që ndeshnim incidente të këtij lloji, por nuk di si ta
19 shpjegoj, nuk mund të trajtonim të gjitha rastet një për një.
20 Duhet ta merrnim situatën ta trajtonim në tërësi në mënyrë që
21 të kishim përkrahjen e publikut në përgjithësi. Dhe kjo është
22 përshkruar në raport dhe është e qartë në atë zonë në ato
23 momente që ende s'e kuptonte popullata që paqja, do t'i vilnin
24 frytet paqes.

25 PY. Z. Covey, do të kaloj tek një temë tjetër që u diskutua

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 16

1 me juve dhe është libri i Gjeneralit Reinhardt. Ju janë
2 treguar disa pjesë. Do t'ju tregoj dhe sisa pjesë të tjera
3 tani të librit.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem shfaqni në
5 ekran SPOE40015904 deri në SPOE40016230-ET E Rishikuar E
6 Kombinuar Pjesërisht. Dhe në gjermanisht nuk i kam citimet e
7 Trupit Gjykues në gjermanisht.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në qoftë se mund t'ju ndihmoj
9 numri ERN është i njëjti për të dy.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull atëherë. Faleminderit.
11 Është, pra, i njëjti numër ERN dhe në gjermanisht. Në qoftë se
12 mund të kalojmë në faqen SPOE40015949, që duhet të jetë faqja
13 91. E kisha fjalën në 91 në versionin PDF. Jo, në fakt kërkoj
14 ndjesë.

15 Z. Sekretar, në anglisht besoj duhet të jetë faqja
16 vijuese. Kërkoj ndjesë, një faqe më para. Nuk e kuptoj se ku
17 jemi ngatërruar. Numri SPOE në krye nuk korrespondon me atë që
18 po kërkojmë, s'përputhet. Në fakt faqja ERN duhet të jetë
19 SPOE40015949.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Besoj që pjesa në fund të numrit
21 duhet të jetë me -ET Rev-combined që është E Rishikuar së
22 Bashku, kombinuar.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, në qoftë se mund t'ju
24 ndihmoj, dokumenti që sapo shfaqët në ekran duhet të jetë ai
25 që kërkojmë në faqen 7 PDF. Ky është.

1 PY. Pra, në anën e majtë të dokumentit pastaj në anën e
2 djathtë kolona, Gjenerali Reinhardt shkruan.
3 "Pastaj ne ju kthym të ardhmes politike të Kosovës. E
4 bëra të qartë që bashkësia ndërkombëtare nuk do të pranonte
5 një Kosovë që është e pavarur për vetëm dhe vetëm shqiptare.
6 Thaçi foli për të ardhmen e Kosovës shumë etnike, multietnike
7 dhe më siguroi që serbët që qëndrojnë në Kosovë nuk do të
8 dëboheshin. Unë theksova ndihmën financiare nga perëndimi që
9 kjo, pra, mund të sigurohej vetëm përmes bashkëjetesës
10 paqësore - siç është e shënuar në Rezolutën e Kombeve të
11 Bashkuara 1244 - të cilën Thaçi e pranon tërësisht. Ne
12 diskutuam situatën e tendosur në Rahovec në hollësi dhe i
13 kërkova atij rekomandime për një zgjidhje paqësore. Thaçi e
14 bëri të qartë se njerëzit atje kishin frikë nga rusët të
15 cilëve nuk duhej t'u jepej qasje në qytet në asnjë rrethanë,
16 në asnjë mënyrë. Megjithatë, ai sheh një mundësi që ata të
17 vendosin, të stacionohen diku afër qytetit."

18 Pyetja ime e parë, Z. Covey, është: A është qasja e z.
19 Thaçi e shënuar këtu me Gjeneralin, pra, siç është shënuar me
20 Gjeneralin Reinhardt në përputhje -- a përputhet kjo me atë që
21 keni kuptuar ju mbi mënyrën sesi z. Thaçi e ka trajtuar
22 bashkëjetesën multietnike, ndëretnike?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, kam disa që do t'i

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 18

1 paraqes për pranim në prova. A mund t'i bëj këto ndoshta në
2 fund?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
4 preferoja që t'i paraqisnit faqet në mënyrë individuale
5 secilën.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëhere do ta bëj, do të dorëzoj
7 faqen që përfundon me P04497.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
9 kundërshtim?

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, por do të doja të përfshinim
11 dhe fillimin që tregon datën e kësaj, këtij dokumenti, pra, që
12 të jetë sa më i plotë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Kur thoni "fillimin" e keni fjalën
14 për faqen në tërësi apo faqen paraprake?

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Besoj që është faqja paraprake,
16 nuk e shoh që është e përfshirë këtu.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Atëherë, SPOE40015948
18 deri në 49.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE40015948
20 dhe 49 pranohen.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo i shtohet. Këto
22 dokumente i shtohen provës materiale P04497 dhe aktualisht
23 klasifikohet si publike.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do të kalojmë në faqen tjetër
25 që është SPOE400015959. Dhe të zmadhojmë pak që të lexojmë.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 19

1 PY. Dhe ju shkruani aty:

2 "Ne pastaj diskutuam çështjen, situatën politike të
3 brendshme. Thaçi deklaroi se ai ishte gati të gjende një
4 kompromis me Ibrahim Rugovën dhe udhëheqësit e tjerë politik
5 për të përmirësuar bashkëpunimin me Kouchner dhe me Këshillin
6 Ekzekutiv të Kosovës.

7 "Jam i kënaqur me rezultatin e këtij takimi të parë me z.
8 Thaçi. Ne krijuam një raport personal të mirë, takimi ishte
9 konstruktiv dhe hapi dyert për bashkëpunim të mëtejshëm, të
10 ardhshëm. Megjithatë, nuk jam akoma në gjendje të vlerësoj
11 këtë person, ai është shumë i kujdesshëm.

12 "Sapo u largova nga z. Thaçi, z. Ibrahim Rugova erdhi me
13 përkthyesin e tij."

14 Pyetja e parë, përshkrimi i z. Thaçi këtu, a pajtoheni ju
15 me të?

16 PË. Po. Tani, z. Thaçi është zhvilluar me kalimin e kohës.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, paraqes këtë faqe për
19 pranim si provë, pra, SPOE40015950 dhe kërkoj që t'i shtohet
20 provës materiale P04497.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
22 kundërshtim?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE4001590
25 pranohet dhe i shtohet sipas kërkesës provës materiale

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 20

1 ekzistuese.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të më kujtoni datën e këtij
3 dokumenti?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
6 Gjykatës. Kjo faqe i shtohet provës materiale P04497.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Data është 9 tetor 1999.

9 PË. Më 9 tetor. Në rregull atëherë. Ai sapo kishte filluar
10 vizitat e tij, pra, ky duhet të jetë takimi i parë me z. Thaçi
11 që ai ka zhvilluar.

12 Pra, këtu duhet ta lini mënjane atë që unë shtova kur
13 thashë që Thaçi ishte duke u zhvilluar. Thaçi në atë kohë
14 kishte një përvojë të gjatë tashmë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do të kalojmë në faqen 957.
16 Duhet të jetë SPOE40015957. Po, kjo është. Në anën e djathtë
17 të versionit në anglisht.

18 PY. Ai thotë -- kjo është data 13 tetor 1999. Thotë:

19 "Është interesante të shihet se udhëheqësit politikë të
20 të gjitha partive dhe grupeve etnike në mënyrë unanime u
21 angazhuan për mbështetjen e tyre për një Kosovë shumë etnike
22 dhe për bashkëpunim të ngushtë për të siguruar një të ardhme
23 paqësore. Ata dënuan përdorimin e dhunës fizike dhe mbështetën
24 autonomi më të gjerë për Kosovën në vend të pavarësisë. Të
25 gjithë udhëheqësit shqiptarë deklaruan gatishmërinë e tyre për

1 të marrë pjesë në Këshillin Ekzekutiv të Kouchner, qeveria e
2 ardhshme e tij. Hashim Thaçi në mënyrë të qartë bëri thirrje
3 për Trupat Mbrojtëse të Kosovës që do të ishin jo politike,
4 tërësisht civile dhe shumë etnike, misioni i të cilave do të
5 ishte të ndihmojë në rindërtimin e vendit dhe në mbrojtjen e
6 kosovarëve nga fatkeqësitë. Ashtu si edhe unë, Kofi Annan dhe
7 Bernard Kouchner e kanë të vështirë të besojnë të gjithë
8 gjërat pozitive, e kishin të vështirë të besojnë gjërat
9 pozitive që po dëgjoni. Ne shpresojmë që këta politikanë të
10 regjur, të shkathët mendojnë atë që po thonë.”

11 [Nuk ka përkthim]

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, në qoftë se mund të
13 shfaqim në ekran SPOE40016107. Faqja 63 në versionin PDF. Po,
14 ky është.

15 PY. Kjo është e datës 13 shkurt 2000. Edhe ai shkruan:

16 “Vonë në mbrëmje u takova me Hashim Thaçi i cili dukej
17 stërlodhur. Më dha siguri që shqiptarët nuk kishin interesa që
18 të sulmonin KFOR-in. Ai u distancua nga incidentet por në të
19 njëjtën kohë theksoi se aftësia e tij për të patur ndikim tek
20 forcat e jashtme është e kufizuar. Megjithatë, ai premtoi se
21 do të bënte gjithçka që mund të bënte gjatë natës për të
22 stabilizuar gjendjen. Ai vetë dukej i tronditur nga ajo që
23 kishte ndodhur në Mitrovicë.”

24 A është kjo pjesë, a përputhet kjo pjesë me përvojën që
25 keni patur ju me z. Thaçi në përpjekjet e tij për të zbutur

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 22

1 dhe ulur tensionet?

2 PË. Po. Përfshirë faktin që ai pranoi se aftësia e tij për të
3 ndikuar ishte e kufizuar.

4 PY. Faleminderit.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, paraqes SPOE40016107
6 dhe kërkoj që t'i shtohet provës materiale P04497.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
8 kundërshtim?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime. Thjesht
10 kërkojmë që faqja që përfundon me 6105 të jepet data e
11 dokumentit.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 SPOE4006105 dhe 6107 pranohen dhe i shtohen provës materiale
15 P04497.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. Tani do të kthehemi tek një libër tjetër që është libri
18 juaj, Z. Covey, juve ju tregua faqja 100 e librit që u pranua
19 si P04496.2. Një prej fjalive aty ishte:

20 "UÇK-ja gjurmonte dhe gjuante, kërkonte serbët të cilët
21 kishin qenë të përfshirë në luftë, po ashtu dhe
22 bashkëpunëtorët ndër të cilët bashkëpunëtorë nga pakicat e
23 tjera, komunitetet e tjera në veçanti turqit dhe romët ..."

24 Dhe pastaj vazhdon:

25 "Dhe edhe pse shqiptarët etnikë -- edhe shqiptarët etnikë

1 që ata i konsideronin thjesht si persona që kishin patur
2 bashkëpunim të tepërt me shtypësit serbë konsideroheshin si të
3 tillë. Ekstremistët e UÇK-së ishin të vendosur që të dëbonin
4 serbët jashtë Kosovës duke përdorur dhunën dhe terrorin.”

5 Kur thoni “UÇK-ja gjuante, kërkonte, pra, serbët” të
6 cilët -- kush ishin këta persona në UÇK për të cilët e keni
7 fjalën ju?

8 PË. Mund ta kemi kthyer, mund ta kemi ndryshuar, pra, theksin
9 në mënyrë që theksi të vihej tek ekstremistët e UÇK-së.

10 PY. E konsideronit ju Agim Çekun apo Hashim Thaçin si
11 ekstremistë të UÇK-së?

12 PË. Në fakt, jo. Në fakt është krejt e kundërta.

13 PY. Dhe ju tregua faqja 105 e librit tuaj që është pranuar si
14 P44096.4, ku shkruhet:

15 “Edhe pse komandantë të UÇK-së ‘kishin ndihmuar’ në
16 disfatën e serbëve, ata ndjen; se KFOR-i tani nuk po iu jepte
17 atyre mundësinë që të përfundonin punën që kishin filluar,
18 (pra, që të largonin serbët nga vendi).”

19 Për cilët komandantë të UÇK-së e kishit fjalën aty?

20 PË. Në këtë pjesë besoj të kem patur në mendje komandantët e
21 zonave dhe disa prej të cilëve ishin ekstremistë.

22 PY. Kishit në mendje Gjeneral Çeku dhe z. Thaçi?

23 PË. Absolutisht që jo.

24 PY. Juve ju tregua faqja -- kërkoj ndjesë. Të kaloj tek një
25 temë tjetër. Dje, juve ju pyetën për një pjesë të librit tuaj

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 24

1 dhe diskutuat formimin e PDK-së?

2 PË. Po.

3 PY. Pra, partinë politike të z. Thaçi dhe kjo ishte në
4 transkriptin e përkohshëm faqja 76, rreshtat 20, 25 dhe juve
5 ju lexua pjesa e librit tuaj si më poshtë:

6 "Në shtator 1999 UÇK-ja filloj tranzicionin e saj drejt
7 TMK-së. Vetëm tre muaj më vonë, Partia Progresive Demokratike
8 e Kosovës, PDK-ja, shpalli formimin e saj si parti me z. Thaçi
9 si kryetar i saj. Shumica e grupeve rajonale të cilët kishin
10 shërbyer në rrjetin politik të UÇK-së u konsoliduan në PDK me
11 pjesën që ngelte -- dhe pjesa që ngeli u bashkua Aleancës për
12 të Ardhmen e Kosovës që është AAK-ja, partia e Ramush
13 Haradinajt, i vetmi udhëheqës i UÇK-së i lartë i cili dukej të
14 kishte ..."

15 Dhe kjo është në dokumentet që kemi paraqitur sot në
16 mëngjes.

17 PËRKTHYESI: I kërkojmë avokatit që të ngadalësojë ritmin
18 me qëllim që përkthyesit të mund të përkthejnë. Nuk e kemi
19 tekstin.

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Këtu e shihni që raporti është i 12 korrikut 1999,
22 raporti i OSBE-së.

23 Dhe raporti mbulon periudhën 5, 7 korrik 1999.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë tani në krye
25 të faqes së tretë.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 25

1 PY. Dhe shohim dy parti të reja politike u krijuan, të dy
2 pretendojnë që janë përfaqësues politikë të UÇK-së. Lëvizja
3 për Çlirimin e Kosovës (LKÇK-ja) kryesohej nga Valon Murati,
4 ka kryesues Valon Muratin. Partia Bashkimi Demokratik (PBD-ja)
5 udhëhiqet nga Bardhyl Mahmuti. Kjo parti është një fragment i
6 Lëvizjes Çlirimtare të Kosovës (LPK) e cila ka mbështetur UÇK-
7 në nga jashtë dhe duket të ketë mbështetjen e udhëheqësve,
8 pjesës dërrmuese të udhëheqësve të UÇK-së. Hashim Thaçi,
9 udhëheqësi i UÇK-së deri tani nuk ka shprehur mbështetjen e
10 tij për ndonjërin prej këtyre partive politike.”.

11 Z. Covey, ishiti në dijeni se kishte shumë parti të reja
12 politike që po dilnin nga UÇK-ja përpara se të arrinit ju në
13 Kosovë?

14 PË. Ju thatë shumë saktë, pra, që po dilnin nga UÇK-ja. Dhe
15 këto parti, ne nuk ishim të mirinformuar, le të themi, me të
16 gjitha pikat, nuancat dhe dallimet mes këtyre partive apo
17 krijimin e këtyre partive politike.

18 PY. Faleminderit.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, e paraqes këtë
20 dokument për pranim, SITF00011454 deri në 00011457.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
22 kundërshtim?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo. Dhe mund të jetë publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 00011454 deri
25 në 11457 pranohet dhe riklasifikohet si publik.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 26

- 1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ka numrin e provës
2 materiale 1D00422, klasifikohet si publik.
- 3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.
- 4 PY. Z. Covey, kam edhe disa pyetje për ju. Keni qenë dy ditë
5 me neve tashmë duke dhënë dëshmi dhe keni parë shumë
6 dokumente, video, libra. Keni parë gjatë këtyre ditëve ndonjë
7 urdhër të lëshuar nga z. Thaçi ndokujt në UÇK?
- 8 PË. Jo.
- 9 PY. Keni parë ndonjë raport nga dikush në UÇK të drejtuar z.
10 Thaçi?
- 11 PË. Raporte nga persona të UÇK-së drejtuar z. Thaçi?
- 12 PY. Po.
- 13 PË. Jo.
- 14 PY. A keni parë ndonjë gjë këtu që mund t'ju çojë të dyshoni
15 në vlerësimin tuaj se z. Thaçi nuk ishte në gjendje për të
16 parandaluar apo ndëshkuar krimet e kryera nga pjesëtarët apo
17 nga ish-pjesëtarët e UÇK-së?
- 18 PË. Jo, po përpara se të përfundoja të them diçka se si kemi
19 arritur në këtë vlerësim.
- 20 PY. Vazhdoni.
- 21 PË. E kuptoj se disa prej nesh bëjnë një paraqitje pak më të
22 butë, dikush që nuk i ka të gjitha informacionet mund të bëjë
23 edhe pyetjen nëse një person i tillë është pak naiv apo
24 ndoshta është mashtruar nga fjalë të bukura. Por ne, dhe këtu
25 po përfshij edhe Bernard Kouchner dhe veten, nuk jemi

1 fillestarë në këtë. Në atë kohë ne i njohim këto lojëra, këto
2 gjëra. Në atë kohë, kur shkova atje, unë kisha 30 vjet përvojë
3 në shërbimet e jashtme dhe kudo, përfshirë edhe shërbime në
4 ushtri. Kemi patur situata ku kemi trajtuar gjithçka, pra, nga
5 kultura luftarake ekstreme tek njerëz jashtëzakonisht të këqij
6 me qëllime të tmerrshme deri tek frikësimi, politikanë të
7 zgjuar të cilët donin që të kuptonin, të gjenin një mënyrë për
8 të shprehur atë që mendonin dhe për ta thënë në mënyrë që të
9 vinte në vesh tonë ashtu siç ne donim dhe ta besonim.

10 Siç e thashë dje, në profesionin tim, e dimë që prej
11 fillimit, ne nuk mund të presim që të kemi informacionin e
12 plotë apo të gjitha informacionet dhe megjithatë pritet nga ne
13 që të arrijmë në përfundime që qeveritë tona, presidentët tanë
14 -- në të cilët presidentët dhe qeveritë tona mund të
15 mbështeten. Dhe mendoj se të dhënat dhe dosjet tregojnë se
16 gjatë jetës time profesionale unë e kam përmbushur këtë
17 objektiv dhe kam qenë në nivel të kësaj sfide.

18 Pra, në Kosovë neve na u prezantua, na u paraqit në këtë
19 rast, në këtë shembull konkret, ky person, njeri i ri që ishte
20 ndoshta jo shumë i zhvilluar, po në të njëjtën kohë shumë
21 ambicioz dhe shumë i zgjuar me ambicie politike që ishin
22 përtej aftësisë së tij për të imponuar këto ambicie. Dhe ne
23 pamë këtë gjë me interes se si ai po përpiqej të gjente
24 rrugëtimin e tij dhe të ecte përpara në këtë rrugë të cilën
25 nuk e njihte më parë, nuk kishte përvojë.

1 PY. Më lejoni t'ju bëj një pyetje që ndoshta mund t'ju japë
2 mundësinë të përfundoni edhe përgjigjen tuaj.

3 PË. Po.

4 PY. Sepse pyetja ime e fundit është: A keni parë ndonjë gjë
5 që do t'ju bënte të mendonit apo të besonit se z. Thaçi
6 përpigjej të merrte pushtetin në Kosovë përmes apo duke kryer
7 krime kundër kundërshtarëve të tij goftë personalisht duke
8 kryer krime apo përmes pjesëtarëve të tjerë të UÇK-së që
9 kryenin këto krime, pra, në interes të tij?

10 PË. Jo. Dhe mendoj se shumë shpejt kemi arritur në vlerësimin
11 se ai nuk e kishte pushtetin, autoritetin, marrëdhëniet,
12 marrëdhënien për autoritetin personal për të bërë që dikush
13 tjetër të bënte një gjë të tillë. Për më tepër, unë dhe ne
14 arritëm në këtë vlerësim, se ai e dinte se nuk i kishte këto
15 gjëra, nuk e kishte këtë pushtet, këtë fuqi, pra, ai filloi
16 këtë karrierë duke zbuluar hap pas hapi atë që mund të bënte
17 dhe si mund ta bënte për të krijuar rrugëtimin e tij politik.

18 Ai ishte në të njëjtën kohë -- nuk na përket neve që të
19 gjykojmë nëse ai me gjithë mend dëshironte më të mirën për
20 Kosovën, apo se si mund të analizoheshin ambiciet e tij në
21 mënyrën më të mirë, ai e gjeti vetë këtë mënyrë për ta bërë
22 këtë - dhe ishte detyra jonë që ta ndihmonim ne në këtë
23 rrugëtim - pra, duke punuar me UNMIK-un, duke punuar me
24 institucionet, kjo u ka shërbyer dhe interesave të tij. Ky
25 është angazhimi më i mirë që mund të kërkohet nga një

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 29

1 politikani që po bën atë që duhet të bëjë, por njëkohësisht
2 kjo gjë, këto veprime i shërbenin dhe interesave të tij
3 personale dhe ne kemi vlerësuar se ai po ndiqte këtë rrugë dhe
4 po e arrinte këtë gjë. Dhe e ritheksoj se nuk ishte vlerësim
5 që u arrit, nuk besoj, duke qenë naiv. Ne e kishim një shikim
6 të qartë dhe një gjykim të qartë dhe prisnin të shihnim sesi
7 z. Thaçi do të shfaqej më tej në raport me neve.

8 PY. Z. Covey, faleminderit për pyetjet tuaja.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Me këtë përfundoj pyetjet që
10 kisha. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të marrim
12 dhjetë minuta pushim. Në fakt pushimi do të zgjasë deri në
13 10.15.

14 Mund të largoheni nga salla e gjyqit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
17 ndërpritet në orën 10.03 minuta.

18 --- Seanca ndërpritet në orën 10.03

19 --- Seanca rifillon në orën 10.15

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Iodice,
21 keni diçka shtesë që deshët ta trajtonit tani dhe ka të bëjë
22 me emailin e dërguar në mëngjes?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Prova
24 materiale P04496, libri i z. Covey, secila prej faqeve është
25 pranuar me numra rendor .1, .2, .4. Do të kërkonim që të

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 30

1 gjitha këto faqe të mund të pranohen me një numër të vetëm,
2 nën një numër të vetëm si provë e vetme, do të ishte më e
3 lexueshme.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Jemi dakord me këtë propozim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ashtu
7 do vazhdojmë.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë të gjitha faqet
9 e pranuar, pra, P04496.1, .2, .3, .4, .5, .6 do të pranohen
10 me shifrën P04496. Kjo nënkupton që P04496.1, .2, .3, .4, .5,
11 .6 do të mund të fshihen.

12 Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani kemi
14 disa pyetje të Trupit Gjykses, po së pari duhet të sjellim në
15 sallë dëshmitarin.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Covey,
18 kemi disa pyetje nga anëtarët e Trupit Gjykses, duke filluar
19 me Gjykatësin Barthe që është këtu në të majtën time, në të
20 djathtën tënde. Ju lutem jepini vëmendjen e duhur.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Smith.

23 Pyetjet nga Trupi Gjykses:

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Z. Covey,
25 kryesisht dhe fillimisht për durimin tuaj.

1 PË. Faleminderit.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykses, siç e tha
3 edhe Kryegjykatësi, ka disa pyetje që kanë të bëjnë me
4 vlerësimin e dëshmisë tënde dhe për këtë arsye do të shkojmë,
5 do të trajtojmë deklaratën që i keni dhënë Palës Mbrojtëse dhe
6 që keni shkruar më datën 12 gusht 2025 për të sqaruar disa
7 sqarime.

8 PË. Faleminderit.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Covey, po fillojmë me
10 disa të dhëna personale. Sipas paragrafit 2 të deklaratës
11 suaj, na i thatë Palës Mbrojtëse që ju u caktuat në qershor të
12 1999 nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi
13 Annan për të shërbyer në misionin e UNMIK-ut në Kosovë si
14 Zëvendësi Kryesor i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të
15 Përgjithshëm, Bernard Kouchner, kështu është?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe duke iu përgjigjur
18 pyetjes së Prokurorisë gjatë ditës së djeshme, thatë që
19 mbërritët në Kosovë së bashku me z. Kouchner më datën 15
20 korrik 1999, kështu është?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sipas deklaratës suaj, në
23 paragrafin 20, u larguat nga Kosova në janar të vitit 2001,
24 kështu është?

25 PË. Besoj se është e saktë. Mund të ketë ndodhur nga fundi i

1 janarit dhe fillimi i shkurtit.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, në Kosovë ishe i
3 punësuar përreth një vit e gjysëm, kështu është?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Covey, gjatë muajit të
6 parë dhe deri në fund të 1999, sa herë apo sa shpesh e keni
7 takuar z. Thaçi afërsisht?

8 PË. Më duhet të hamendësoj, por të paktën gjashtë herë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Sa shpesh e ke
10 takuar z. Thaçi në praninë e komandantëve rajonalë apo të
11 zonave?

12 PË. Vetëm një herë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Bëhet fjalë për takimin që
14 përmende në mes të shtatorit të 1999-s, kur z. Thaçi rrinte
15 veçmas prej komandantëve të tjerë të zonave?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dua të kaloj tani në një
18 tematikë tjetër. Në paragrafin 16 deklaratës suaj, keni bërë
19 disa vëzhgime mes të tjerave, të paktën në deklaratë thuhet,
20 pra, në deklaratën që kam përpara në shkronjën (c), thoni që
21 "gjatë mandatit tuaj, z. Thaçi ka luajtur një rol konstruktiv
22 që ka ndihmuar që t'i çonte më tej synimet paqeruajtëse të
23 UNMIK-ut" dhe nën numrin romak III thotë, "duke ndarë
24 vëmendjen, pushtetin dhe, në fakt dhe meritat me personat të
25 cilët i kishte denoncuar më parë".

1 Për cilët e keni fjalën?

2 PË. Absolutisht. Së pari dhe kryesisht, bëhet fjalë për z.
3 Rugova të cilin z. Thaçi e kishte sharë në mënyrë dramatike
4 dhe në fillim dukej sikur kishte armiqësi të dukshme, të
5 konsiderueshme ndaj tij. Me kalimin e kohës dhe në kuadrin e
6 zhvillimeve ai ndryshoi këtë sjellje në mënyrë thelbësore,
7 brenda disa muajve filloi që të ndante pushtetin me të,
8 vëmendjen me të. Dhe këtu bëhet fjalë për politikanë dhe, si
9 të thuash, ndarja e vëmendjes është diçka shumë e vështirë për
10 një politikan. Pra, ai po ndante pushtetin dhe vëmendjen e
11 këta njerëz me atë person të cilin e kishte sharë më parë.

12 Nuk kam dijeni që ai të ketë patur të njëjtën armiqësi
13 ndaj z. Qosja, po unë kryesisht kisha ndërmend z. Rugova.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Covey, në shkronjën (d)
15 thuhet që, UÇK-ja, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, sipas
16 mendimit tuaj, ishte "një lëvizje tejet e decentralizuar dhe
17 shpesh pa lidhje mes krahëve të saj, kryesisht e përbërë nga
18 persona të fuqishëm autonomë, shumica ishin të dhunshëm dhe
19 shumica nuk kishin respekt, kishin pak respekt apo jo respekt
20 për z. Thaçi".

21 A ju kujtohet që ia thatë këtë Palës Mbrojtëse?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund t'ju pyes se cila
24 është baza për këtë pohim tuajin? Përse menduat që UÇK-ja
25 ishte shumë e decentralizuar e shpesh e palidhur në krahët e

1 saj?

2 PË. Kjo është një përshtypje që kemi marrë nga shumë burime
3 të cilëve ju kemi besuar ose nga raportimet e OSBE-së të cilët
4 kanë qenë të pranishme gjatë gjithë kohës së konfliktit, nga
5 raportet ditore të KFOR-it. Dhe është një proces me osmozë. I
6 cili rezultoi në këtë përfundim të gjithësishtë me të cilin
7 ramë dakord të gjithë ne.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për cilin e ke fjalën për
9 këta persona të fuqishëm të cilët e drejtonin UÇK-në?

10 PË. Kemi përmendur deri tani z. Lushtaku, Ramush Haradinaj
11 ishte një tjetër, dhe këtu kemi të bëjmë me dy personalitete
12 radikale të ndryshme. Ka patur edhe të tjerë, po nuk më
13 kujtohen të gjitha karakteret e kësaj lëvizjeje që t'i them
14 tani.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në mëngjes i
16 thatë avokatit të z. Thaçi që ekstremistët po përpigeshin të
17 dëbonin serbët nga Kosova duke shfrytëzuar terrorin. A të
18 kujtohet?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju thatë se disa prej
21 komandantëve të zonave ishin ekstremistë. Dua t'ju pyes kë ke
22 ndërmend?

23 PË. Sigurisht që në këtë grup do të fusja, në këtë kategori
24 do të fusja z. Lushtaku. Edhe një herë e përsëris, që nuk më
25 kujtohen të gjithë emrat e komandantëve të zonave, nuk jam unë

1 analisti. Unë merrja përfundimet që arrinin analistët.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ke dijeni për individë të
3 moderuar në mes të komandantëve të zonave, njerëz të cilët nuk
4 ishin ekstremistë?

5 PË. Ramush Haradinaj, i cili në fakt ishte luftëtar i ashpër,
6 i rreptë, në fakt, doli se ishte person i moderuar.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do të kaloj tani në një
8 tematikë tjetër, do të flasim për takimin e 16 korrikut 1999
9 në të cilin ti ke marrë pjesë një ditë përpara pas arritjes në
10 Kosovë, në Këshillin Tranzitor të Kosovë, KTK-në, ku thatë që
11 z. Rugova nuk ishte i pranishëm pasi ishte në Itali në atë
12 kohë. Dhe këtu i referohem paragrafit 28 të deklaratës suaj.
13 Ju thatë po kështu që LDK-ja refuzonte të merrte pjesë në KTK.

14 Tani dua të pyes a keni dijeni se përse LDK-ja ka
15 refuzuar të merrte pjesë në KTK? A ishte kjo vetëm për shkak
16 të mungesës së z. Rugova apo për arsye të tjera?

17 PË. Ne kryesisht menduam se kjo i dedikohej mungesës së z.
18 Rugova. Megjithatë, më lejoni të shtoj, që në atë moment, më
19 datën 16, ne nuk kishim dijeni se ku ndodhej z. Rugova, vetëm
20 që ai nuk ishte i pranishëm dhe mbase nuk ndodhej fare në
21 Kosovë. Në ditët në vazhdim, LDK-ja dukej e çoroditur, pa
22 udhëheqje dhe e ndarë dhe dukej që nuk arrinte dot konsensusin
23 që do t'i mundësonte të merrte pjesë në KTK.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse LDK-ja ka qenë
25 pjesë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?

1 PË. A e keni fjalën për Qeverinë e Përkohshme të organizuar
2 në Rambuje?

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po.

4 PË. Po, kështu e kam kuptuar unë, që kanë qenë pjesë e saj.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që ta sqarojmë këtë, pra, ju
6 mendoni që LDK-ja ka marrë pjesë në Qeverinë e Përkohshme?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mbase mund të jeni pak më i
9 saktë, çfarë nënkuptoni me fjalën pjesëmarrje?

10 PË. Mesa kam kuptuar unë, që ata kanë rënë dakord që të ishin
11 pjesë e atij organi që mbeti në fushën e fantazisë, i cili nuk
12 u organizua ndonjëherë. Unë nuk e di se kush ka marrë pjesë në
13 kuptimin e funksionimit të administrimit të një funksioni
14 ekzekutiv. A po i përgjigjem në mënyrën e duhur pyetjes suaj,
15 zotëri?

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po. Mjafton.

17 Po e bëj këtë pyetje pasi përmende tensionin mes UÇK-së
18 dhe LDK-së gjatë luftës. A të kujtohet?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe prandaj desha të dija
21 nëse mund të ishin këto tensione të cilat kanë bërë që z.

22 Rugova nga njëra anë të mos kthehej dot në Kosovë dhe nga ana
23 tjetër të shpjegojë edhe refuzimin për të marrë pjesë në KTK
24 nga ana e anëtarëve të LDK-së.

25 PË. Nuk dua të spekuloj lidhur me arsyet e anëtarëve të LDK-

1 së përveç faktit të Rugovës. Mua më ishte krijuar përshtypja
2 që ishin pa udhëheqës dhe dukej sikur po bënë manovra të
3 brendshme se kush do dilte në krye.

4 Sa i përket Rugovës me kalimin e kohës, mësuam dhe
5 fillimisht përmes Bernard Kouchner që shkoi dhe e takoi, ai
6 ishte depresionuar, ndoshta me depresion klinik - pavarësisht
7 se unë nuk jam mjek - dhe në fakt kishte frikë për sigurinë e
8 tij personale. Dhe Bernard më shpjegoi mua se përpjekjet e tij
9 kryesisht kishin të bënin me faktin apo me bindjen e Rugovës
10 se nëse vendoste të kthehej, siguria e tij do të ishte e
11 siguruar si të thuash. Dhe, në fakt, kjo ishte një sfidë siç e
12 kemi diskutuar më parë, pasi KFOR-i nuk mund të siguronte
13 mbrojtjen e tij personale por mund të siguronte zonën përreth
14 tij. Dhe ne për këtë kishim miratimin e Gjeneralit Jackson.
15 Rugova u kthye pikërisht pas këtyre sigurive. Pavarësisht nëse
16 e ka kuptuar këtë në këtë mënyrë apo jo.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thoni që Rugova kishte
18 frikë për sigurinë e tij personale. A mund të pyes nëse nga
19 bisedat që keni patur me z. Kouchner, përse kishte frikë?
20 PË. Nga bisedat me Bernard Kouchner dhe nga ajo që kemi
21 mësuar nga burime të KFOR-it më vonë, ne kuptuam që të gjithë
22 truporët e tij ishin vrarë, pothuajse të gjithë. Nuk e di
23 nëse kjo është fushë për të cilën më duhet -- mund të flas unë
24 në mënyrën e duhur pasi unë nuk jam i informuar për këtë
25 çështje në mënyrë të drejtpërdrejtë, po KFOR-i besonte që

1 vëllai i Ramushit, Daut Haradinaj, ishte personi përgjegjës
2 për këtë sulm.

3 Në atëherë kohë, ne nuk kemi pasur dijeni për këtë. Kemi
4 mësuar shumë, shumë më vonë. Rugova kishte pikëpamjet e tij.
5 Kishte arritur në përfundimin e tij. Dhe kur ne mësua lidhur
6 me këtë sulm dhe më pas se kush ishte përgjegjës për të,
7 atëherë kuptohej, ishte e lehtë të kuptohej se përse ishte i
8 shqetësuar Rugova për sigurinë e tij.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Daut Haradinaj ka qenë
10 anëtar i UÇK-së? A e dini?

11 PË. Po, kështu e di unë. Unë besoj që ka qenë një nga
12 vartësit, nëse mund të flitej për vartësi në radhë të UÇK-së,
13 ai ka qenë pjesëtar i njësitit perëndimor.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do të kalojmë në paragrafin
15 33 të deklaratës suaj ku keni diskutuar, gjë që është
16 përmendur edhe këtu brenda sallës së gjyqit, diskutuat vrasjen
17 e 14 fermerëve serbë në Graçkë pak pas mbërritjes suaj në
18 Kosovë. Kjo vrasje ndodhi më datën 23 korrik. Këtu në sallë
19 dëgjuam që ndodhi në datën 22, po në fakt ka ndodhur në datën
20 23.

21 Dhe, sipas paragrafit 33 të deklaratës suaj, thatë që ju
22 kujtohet që "z. Thaçi në mënyrë të hapur dhe të përsëritur i
23 dënoi krimet në Graçkë, po se as ai dhe asnjë anëtar tjetër i
24 KTK-së nuk ishte i gatshëm që të nënshkruante një deklaratë
25 për ta dënuar këtë masakër".

1 Z. Covey, a e dini se përse as z. Thaçi dhe asnjë anëtar
2 tjetër i KTK-së nuk ishte i gatshëm për ta nënshkruar një
3 deklaratë të tillë për të dënuar masakrën apo vrasjen e 14
4 serbëve në Graçkë?

5 PË. Jo dhe ende nuk e kuptoj. Unë e kam përmendur gjatë
6 ditëve të shkuara, më duket, që disa prej këtyre zhvillimeve
7 nuk kanë ardhur në rendin e duhur apo kronologjik. Spekulimet
8 tona lidhur me arsyet se përse udhëheqësit shqiptarë,
9 udhëheqësit - politikë, socialë, në media - për ta nënshkruar
10 këtë mund të kenë qenë të tilla dhe u bë e qartë një situatë
11 pak më vonë, pavarësisht se s'e kemi kuptuar se përse, z.
12 Thaçi do të bënte këtë deklaratë, deklarata të tilla në publik
13 por jo brenda KTK-së dhe më çudit kjo dhe ky është një rrezik
14 dhe jo i vogël që ka marrë në atë kohë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, as z. Thaçi dhe asnjë
16 tjetër i KTK-së nuk të ka treguar, nuk ju ka treguar juve se
17 përse nuk kishin dëshirë që ta nënshkruanin deklaratën e
18 përbashkët?

19 PË. Jo.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në të njëjtin paragraf, në
21 paragrafin 33 të deklaratës suaj, ju keni parë dhe lexuar një
22 artikull të gazetës *Washington Post*, apo për ta korrigjuar
23 veten, përkthimi në anglisht të një artikulli, ku thotë "Thaçi
24 e dënon vrasjen" dhe kjo nga gazeta *Shekulli*, ku thotë që
25 "Thaçi i ka dënuar vrasjet në Graçkë dhe ka deklaruar besimin

1 e tij se forcat e UÇK-së nuk kishin të bënë fare me këtë
2 vrasje".

3 Pyetja ime e parë, Z. Covey, është: A e ke parë këtë
4 gazetë, këtë artikull?

5 PË. Do të kem pasur dijeni mbi këtë. Ne e mbikëqyrnim, e
6 ndiqnim shtypin vendor, pavarësisht se nuk ishte një proces i
7 duhur. Ne do të kishim pasur dijeni në atë periudhë kohe, po
8 nuk do të ngelemi prapë të çuditur se përse nuk e ka bërë këtë
9 deklaratë në kohën e takimit të KTK-së.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ke pasur dijeni që z.
11 Thaçi e ka bërë një deklaratë të tillë?
12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dijeni nëse z. Thaçi
14 ka ndërmarrë ndonjë hap për të mësuar se kush ka qenë
15 përgjegjës për vrasjen e 14 serbëve, nëse behej fjalë për UÇK-
16 në apo për të tjerë?

17 PË. Jo, nuk kam dijeni. Nuk do të kisha dijeni për këtë
18 çështje.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dua të
20 diskutoj një temë tjetër tani, negociatat që çuan në
21 nënshkrimin e të ashtuquajturit angazhim, apo marrëveshjes
22 angazhuese, nga ana e UÇK-së në qershor të 1999-s. Kjo është
23 paraqitur në paragrafin 59 të deklaratës suaj dhe është
24 diskutuar në këtë sallë gjyqi. Sipas deklaratës suaj,
25 "oficerët e nivelit të lartë të KFOR-it thanë se ishin të

1 çuditur kur z. Thaçi e nënshkroi këtë marrëveshje me titullin
2 e 'komandantit'". Ne kemi parë këtu një dokument ku thuhet,
3 "komandanti i përgjithshëm i UÇK-së".

4 Ju thatë në të kohë që:

5 "Mesa kuptonit ju, Gjeneral Çeku i ka bërë presion z.
6 Thaçi për ta nënshkruar këtë dhe kjo është gjatë rrugës me
7 helikopter për tek ceremonia e nënshkrimit."

8 A të kujtohet që e ke thënë këtë palës Mbrojtëse?

9 PË. Po. Nuk e di se nga e krijuam këtë mendim, po ishte
10 mendim që e kemi krijuar nga KFOR-i. Nuk mund të deklaroj këtu
11 që është e vërtetë, po këtë kemi dëgjuar.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E keni fjalën për rastin në
13 helikopter me z. Çeku?

14 PË. Po, po. Madje dua të shtoj ne spekuluar se përdorimi i
15 këtij titulli ishte thjesht i përkohshëm, domethënë, ishte i
16 paqartë. Ai ishte dhe kreu i Qeverisë së Përkohshme, apo jo?
17 Po ishte thjesht një spekulim. Ne nuk kishim ndonjë shpjegim
18 asokohe pse e nënshkroi ai marrëveshjen në këtë cilësi.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që ta kuptoni pse po ua bëj
20 këtë pyetje, kemi dëgjuar dëshmi në këtë sallë gjyqi që nisma
21 e z. Thaçi për të nënshkruar marrëveshjen në cilësinë e
22 kryekomandantit të UÇK-së ka ardhur nga anëtarët e UÇK-së që
23 kanë qenë të pranishëm gjatë negociatave. Çfarë mendoni ju,
24 nëse mundeni të komentoni?

25 PË. Ju e keni fjalën për negociatat për këtë marrëveshjen

1 angazhuese?

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po.

3 PË. Nuk kam, nuk mund të komentoj, sepse unë nuk e kam parë
4 dhe as nuk e kam kuptuar kështu asokohe. Nuk përputhet me
5 gjykimin tonë të drejtimit tjetër sa u takon marrëdhënieve të
6 tij me UÇK-në, me komandantët e zonës që ishin të tensionuara.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini ju që z. Thaçi nuk
8 ka qenë i pranishëm gjatë negociatave, por ka qenë i pranishëm
9 vetëm z. Çeku dhe komandantët e zonave?

10 PË. Jo, nuk kam qenë në dijeni të kësaj. Kjo ka ndodhur
11 përpara se të shkonim ne atje.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sipas dëshmisë që përmenda
13 më herët, nisma, pra, propozimi apo sugjerimi ishte të pritej
14 për z. Thaçi të mbërrinte dhe ky propozim ka ardhur nga
15 komandantët e zonave?

16 PË. Po më befson pak.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk jeni në dijeni?

18 PË. Jo nuk jam në dijeni të kësaj.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do flasim për një temë
20 tjetër. Në paragrafin 76 --

21 PË. Do të doja ta kuptoja pak më mirë këtë dëshminë. Në këtë
22 dëshmi është thënë që komandantët e zonave të UÇK-së si organ
23 e kërkuan këtë apo ishin një apo dy individë që e kërkuan
24 këtë? Kush e kërkoi këtë?

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Covey, unë nuk jam

1 personi që mund t'ju jap përgjigje për këtë. Unë jam vetëm

2 këtu për t'ju bërë pyetje.

3 PY. Po u bëra shumë kurioz për këtë që sapo më thatë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Vazhdojmë. Në

5 paragrafin 76 të deklaratës suaj, keni thënë se sipas jush z.

6 Thaçi nuk ishte person i dhunshëm, as nuk kishte dispozita për

7 të qenë një person i dhunshëm. Përkundrazi, e keni thënë:

8 "Z. Thaçi u trembej komandantëve të UÇK-së që në vetvete

9 ishin famëkeqë për dhunë."

10 Ju kujtohet që e keni thënë këtë?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pse e keni thënë? Ku e keni

13 bazuar ju këtë supozim që, në fakt, ishte z. Thaçi ai që u

14 trembej komandantëve të zonave?

15 PË. Që iu trembej? Është e qartë dhe në Rambuje që ai është

16 kërcënuar drejtpërdrejt nëse nuk pajtohej me kërkesat e

17 komandantëve të zonave. Po ishte dhe sjellja e tij në

18 përgjithësi e qartë, mënyra se si ishte shumë i kujdesshëm sa

19 u takon marrëdhënieve me udhëheqjen e lëvizjes së UÇK-së.

20 Sikurse ju thashë pak minuta më herët, në profesionin

21 tonë, ne nuk kemi qasje asnjëherë në informacione të plota. Ne

22 thjesht nxjerrim disa përfundime të cilat i bazojmë, bazuar në

23 ato çka kemi parë, çka kemi dëgjuar, po dhe bazuar në përvojën

24 tonë jetësore. Unë kam qenë në situata të ngjashme me

25 luftëtarë edhe me elementë keqbërës edhe personat që i

1 shfrytëzojnë këto mundësi për të përfituar nga dhuna dhe unë
2 pashë një djalë 30-vjeçar ambicioz, funksionar, politikan do
3 ta thoja më saktë, dhe e thashë: Nuk është ky ai person.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Covey, ju thatë që ishte
5 dhe sjellja e tij në përgjithësi. Pra, z. Thaçi vetë nuk ua ka
6 thënë që kishte frikë nga ndonjë person konkret apo nga
7 komandantët e zonave?

8 PË. Jo, jo, absolutisht. Nuk e lejon krenaria një person ta
9 thotë diçka të tillë. Kjo është e vetëkuptueshme. Absolutisht
10 nuk na befasoi diçka e tillë. Ne e ndjemë, e pamë vetë, e
11 konstatuam vetë diçka ët tillë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në fund të
13 deklaratës suaj, në paragrafin 81, thoni se në bazë të
14 konstatimeve tuaja dolët "në përfundimin se z. Thaçi kishte
15 ambicien dhe objektivin për t'u bërë politikan dhe udhëheqës
16 në Kosovë dhe e dinte se duhet të bashkëpunonte me UNMIK-un që
17 ta realizonte këtë". Këtë ua lexoj sot edhe avokati mbrojtës,
18 sot paradite, të njëjtin paragraf.

19 Tani, Z. Covey, nëse përfundimi juaj është i saktë, pra,
20 që z. Thaçi duhet të bashkëpunonte me UNMIK-un për të
21 realizuar qëllimet e tij, çfarë ju shtyn ju të besoni se
22 deklaratat e z. Thaçi kur thoshte që mos ushtroni dhunë dhe
23 ishte në favor të një shoqërie multietnike, a nuk mendoni që
24 kjo ishte pikërisht -- ai i ka thënë këto sepse donte që ta
25 dëgjonte komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht UNMIK-u?

1 PË. Do ta kthej përgjigjen në disa mënyra. Së pari, në ditët
2 e para, të bësh një deklaratë të tillë ka një rrezik të madh,
3 rrezik politik shumë të madh madje, por, dhe rrezik personal
4 dhe unë këtë e njoh shumë mirë, pra, nga ambientet apo nga
5 vendet ku kam qenë pas një konflikti. Personat që bëjnë
6 komente të tilla të paqëta vuajnë prej tyre. Pra, të bësh një
7 deklaratë të tillë në ditët e para pas luftës nuk ishte me
8 mend.

9 Edhe komente të këtij lloji janë bërë disa herë, pra, në
10 qoftë se po e bënte ai këtë thjesht për kredibilitet të na
11 tregonte ne që "Shiko, se unë thashë gjënë e duhur", atëherë
12 ne do ishin shumë skeptik. Por është e qartë që ai i tha këto
13 publikisht disa herë ditët e para dhe mua më duhet të them që
14 për ne asokohe kjo ka qenë befasi edhe sigurisht që ne e
15 mirëpritëm diçka të tillë.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Covey, z. Thaçi përveç
17 deklaratave publike kundër dhunës, a bëri diçka më shumë, për
18 shembull, u takua me komandantë të zonave, ish-komandantët e
19 UÇK-së, a i dha emrat e personave të dyshuar UNMIK-ut a KFOR-
20 it në dijeninë tuaj apo u zotua që ta gjente personin
21 përgjegjës për krimet, personat përgjegjës për krimet?

22 PË. Jo, asgjë të ngjashme. Ju po më pyesni mua a shkoi
23 konkretisht ai diku në hierarki apo në rrjetin e lëvizjes së
24 UÇK-së, a iu drejtua dikujt në këtë lëvizje të UÇK-së për t'u
25 përpjekur që të zbardhte detaje apo të ndryshonte sjellje, nuk

1 e di. Nuk kam qenë në dijeni të kësaj dhe ai vetë nuk na ka
2 thënë diçka të tillë.

3 Nga ana tjetër, ai ka shkuar në shtëpi serbe. Dhe kjo
4 ishte diçka që mund t'i kthehej kundër në një ambient tjetër,
5 në një vend tjetër.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Covey, keni thënë disa
7 herë që z. Thaçi nuk kishte autoritet, pushtet dhe kontroll
8 mbi personat që dyshohej që kishin kryer vepra penale. Unë dua
9 të kuptoj nëse ka qenë kështu, atëherë pse ju dhe UNMIK-u, pse
10 e kontaktuat? Ju dhe z. Kouchner pse nuk shkuat tek personat
11 që në fakt e kishin këtë pushtet dhe këtë ndikim mbi personat
12 në fjalë?

13 PË. Ne donim ta inkurajonim z. Thaçi që t'i trajtonte këto
14 problematika --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju
16 dëgjojmë mirë. Nuk ju dëgjojmë mirë?

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Më dëgjoni më mirë tani?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni,
19 ishte faji im.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Më falni, nuk e
21 mbaj mend për çfarë po flisnim.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pa problem. Unë ju thashë --
23 po e përsëris pyetjen. Ne duam të kuptojmë këtë, në qoftë se
24 z. Thaçi nuk kishte autoritet, ndikim, sipas jush, ndaj
25 personave, sidomos ndaj personave që dyshohej se kishin kryer

1 vepra penale, atëherë pse ju dhe z. Kouchner e kontaktuat z.
2 Thaçi, pse i kërkuat atij t'i trajtonte këto problem? Pse nuk
3 iu drejtuat personave që mendonit që e kishin këtë pushtet?
4 PË. Së pari, ne nuk kishim marrëdhënie të drejtpërdrejta me
5 udhëheqësit e lëvizjes së UÇK-së, ky ishte roli i KFOR-it. Së
6 dyti, donim ta nxisnim, ta inkurajonim z. Thaçi që të përpiqej
7 të bënte diçka, që të shihte çfarë mund të bënte, çfarë ishte
8 në gjendje të bënte. Ai pretendonte se kishte një rol të
9 caktuar dhe nëse kishte autoritet kjo do ishte një gjë shumë e
10 mirë. Ne mendonim se më së paku duhet t'ia kërkonim diçka të
11 tillë, por pritshmëri të larta nuk kishim asokohe që ai do të
12 bënte diçka apo që mund të bënte diçka. Është shumë e
13 thjeshtë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Covey, pot paradite
15 avokati i z. Thaçi ju pyeti lidhur me demarshin që u diskutua
16 edhe dje. A ju kujtohet?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thatë, kjo mund të shihet
19 në faqen 12 të transkriptit të ditës së sotme, ju thatë që Nju
20 Jork, kur thoni Nju Jork, ma merr mendja e keni fjalën për
21 selinë e OKB-së?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, Nju Jorku priste që ju
24 të përcillnit të njëjtën porosi si z. Thaçi dhe z. Çeku. Unë
25 do të doja të dija nëse ju i thatë Nju Jorkut që nuk ka kuptim

1 ta përfshijmë z. Thaçi në këto veprimtari sepse nuk ka
2 autoritet apo kontroll?
3 PË. Jo. Marrëdhënia jonë me Nju Jorkun ishte e ndërlikuar. Ne
4 nuk i mirëprisnim shumë udhëzimet prej nju Jorkut sepse ata
5 nuk e kishin të qartë panoramën apo situatën në terren. Ata
6 sigurisht ishin objekt trusnish dhe ne nuk ishim
7 drejtpërdrejtë Sekretariati i OKB-së që është kryesisht
8 përgjegjës për Këshillin e Sigurisë, ku ishte një ambasador
9 shumë i zgjuar dhe me shumë ndikim. Po flas për z. Lavrov,
10 pra, besoj e keni të qartë. Pra, ne ishim në dijeni që
11 pikëpamjet e tyre lidhur me çdo temë apo çdo aspekt që mund të
12 gjeneronte apo të çonte në ankesa nga pala ruse, atëherë
13 situata bëhej shumë e komplikuar. Dhe kjo është pasqyruar në
14 pikëpamjet e tyre sa i takon DDR-së, pra, transformimit nga
15 UÇK-në në TMK.

16 Pra, nuk i informonim tërësisht, jo. Nuk po them që nuk i
17 informonim fare, po nuk jepnim me dëshirë informacione sa u
18 takon operacioneve të KFOR-it dhe nuk i mirëprisnim këto lloj
19 udhëzimesh prej tyre.

20 Në libër do të shihni që është folur për një diskutim që
21 ne e quajmë sjellje të "një vendi të vogël". Ishte e qartë se
22 z. Kouchner kishte marrë mandatin, po ama ishte po ashtu e
23 qartë se ai ishte i vetmi person në këtë rruzull tokësor që
24 vërtetë kishte investuar për atë mandat. Çdo aktor tjetër,
25 përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm, kishin interesa të tjera

1 që deshën të përmbushnin dhe gjithmonë përpigeshin të gjenin
2 një lloj kompromisi sa i takon mandatit që i ishte dhënë
3 specifikisht z. Kouchner. Ne ishim tërësisht në dijeni të
4 kësaj, pra, ishte i fokusuar në zbatimin e mandatit, siç e
5 kishte kuptuar mandatin, po dhe në të njëjtën kohë ta mbronin
6 atë mandat nga persona të tjerë që kishin interesa
7 konfliktuale.

8 Pra, kështu e kemi trajtuar ne këtë udhëzim konkret, këtë
9 desha t'ju sqaroja.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, Z. Covey, ju keni pasur
11 takim me Gjeneralin Çeku dhe thatë ju supozuat se z. Kouchner,
12 po nuk e dini me siguri nëse z. Kouchner u takua me z. Thaçi,
13 po ju supozoni se ka ndodhur?

14 PË. Po, kam supozuar. Dhe u përpoqa, e shtrydha trurin për të
15 kujtuar nëse është bërë ndonjë takim konkret, po akoma nuk jam
16 i qartë, prandaj i qëndroj kallëzuesit "supozoj".

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Po pse u takuat
18 ju me z. Çeku dhe z. Kouchner me z. Thaçi? A ka pas ndonjë
19 arsye konkrete për këtë, pse u mor ky vendim?

20 PË. Jo, do të duhet të spekuloj pak tani. Unë kisha
21 marrëdhënie të mirë pune me z. Çeku. Sidomos tani që po
22 formohet TMK-ja, ende s'ishte formuar, akoma s'ishte tërësisht
23 funksionale, por ishte pjesë e fushëveprimit të UNMIK-ut dhe
24 z. Kouchner ishte fokusuar më në përgjithësi, në vija më të
25 përgjithshme për tërë Kosovën, synonte që Kosova të shkonte

1 drejt një rrugëtimi demokratik. Pra, kishim ndarë detyrat pak
2 a shumë. Nuk ishte nevoja që të dy ne të bënim çdo gjë që
3 mundej, të bënim çdo gjë bashkë, pra, mund t'i ndanim detyrat.
4 Besoj se ky është shpjegimi që mund t'ju jap.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A është marrë vendim i
6 përbashkët mesa ju kujtohet ju apo ka qenë ky vendim i z.
7 Kouchner?

8 PË. Mund ta kem propozuar dhe unë, por nuk më kujtohet
9 konkretisht.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e fundit - pastaj
11 bëjmë pushimin - temë tjetër kjo. A e dini nëse njësitë
12 paraushtarake, paramilitare në Serbi kanë operuar ende në
13 Kosovë pas 20 qershorit 1999? Keni informacion?

14 PË. Nuk kam informacion për këtë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk e dini?

16 PË. Jo, nuk e di.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Z. Covey.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Do bëjmë gjysëm ore pushim tani, Z. Covey. Ju lutem mos
21 diskutoni me askënd dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
25 deri në orën 11.30.

1 --- Pauza fillon në orën 11.00

2 --- Seanca rifillon në orën 11.30

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duke pasur
4 parasysh urdhrin gojor të Trupit Gjykses në lidhje me P4492
5 MFI dhe vendimin që nxorëm, duhet të sqarojmë për nevoja të
6 procesverbalit, do të qartësojmë procesverbalin duke hequr një
7 dokument. Në përputhje me urdhrin gojor në transkriptin e
8 datës 30 shtator 2025, faqe 27326 deri në 27327, Trupi Gjykses
9 qartëson se prova materiale P04492 do të hiqet.

10 Fillimisht do të shoh në qoftë se ka ndonjë kundërshtim,
11 apo dëshironi ta shikoni fillimisht?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk i kam të gjitha provat
13 materiale.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 S'besoj që të ketë kundërshtime.

16 Znj. Asistente, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
19 z. Covey. Radhën e ka Gjykatësi Mettraux që është në anën e
20 djathtë timen, në anën e majtë tuaj, i cili do t'ju bëjë disa
21 pyetje.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

23 Mirëmëngjesi, z. Covey.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kemi dy-tre fusha të

1 veçanta për të cilat iu janë bërë pyetje juve dhe të cilat dua
2 që të bëj pyetje shtesë. Do t'ju tregoj disa dokumente pastaj
3 do t'ju bëj pyetje lidhur me to.

4 Së pari, është prova materiale P1223.

5 Besoj që e keni më parë më parë këtë dokument. Merrni
6 kohën që ta rishikoni, ta rilexoni. Po a është e saktë të
7 themi që ky dokument është -- ju është dërguar juve dhe z.
8 Kouchner?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet të keni parë
11 këtë dokument në veçanti, pra, konkret, në atë kohë?

12 PË. Do të thoja, në qoftë se më lejoni, që kemi parë shumë
13 dokumente. Supozoj ta kem parë. Në qoftë se lexoj pak më
14 poshtë në faqe ndoshta më kujtohet diçka konkrete. Po është
15 tamam lloji i dokumenteve që na paraqiteshin, na jepeshin.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] S'ka problem me këtë fare,
17 zotëri, edhe në qoftë se ka diçka që nuk ju kujtohet, mjafton
18 të thoni kështu. Tërheq vëmendjen tek diçka e veçantë për të
19 cilën dua t'ju bëj pyetje.

20 PY. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë në
22 faqen në vijim dhe shohim pak më poshtë në dokument. Aty, në
23 rregull.

24 Z. Covey, do t'ju kërkoja që të shikonit pikën e dytë me
25 titullin "Veprimet e paligjshme", e shikoni këtë?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Lexojeni pak dhe do t'ju
3 lexoj transkriptin. Aty thuhet:

4 "Gjithnjë e më shumë Administrata Rajonale përballet me
5 veprime të paligjshme si mbledhja e taksave e paligjshme,
6 zhvatja, 'seanca informative', dëbime nga shtëpi të
7 paligjshme. Në raste të caktuara ata përballen me sjellën
8 jobashkëpunuese të "Qeverisë" apo përfaqësuesve të qeverisjes
9 të emëruar nga UÇK-ja, përfshirë sulme verbale në radio.
10 Administratorët Rajonalë pyesin se deri ku mund të shkojnë në
11 përpjekjet e tyre për të -- çfarë mund të bëjnë, pra, për të
12 parandaluar këto veprime."

13 Dhe pastaj "Vazhdimi" është:

14 "JHL të ngrejë këtë çështje me PSSP-në dhe t'i informojë
15 ata për qasjen e përgjithshme që duhet të kenë."

16 Pyetja ime e parë është nëse ju kujtohet që e keni marrë
17 këtë lloj informacioni në atë kohë?

18 PË. Këto janë lloj informacionesh që sigurisht kemi marrë,
19 po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini nëse çfarë
21 veprimesh janë marrë më tej lidhur me këtë çështje, në qoftë
22 se janë ndërmarrë veprime?

23 PË. Shoh që këtu është referenca JLH, nuk jam i sigurt kush
24 është kjo. Zëvendësi i PSSP-së duhet të ketë qenë zëvendësi i
25 Shtyllës II, pra, çështjet civile, Tom Koenigs, dhe nuk e di

1 cili ka qenë rezultati konkret i konsultimeve, por mund të bëj
2 një koment të përgjithshëm, në qoftë se më lejoni.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vazhdoni.

4 PË. Ne jemi në këtë pikë, pra, bëhet fjalë ku kemi dy muaj e
5 gjysëm që kemi filluar këtë proces. Dhe në këtë kohë nuk
6 kishim akoma -- nuk kishim një administratë të përbashkët
7 fare. Burimet, mjetet, mundësitë tona në terren ishin shumë të
8 kufizuara. Stafi i policisë ndërkombëtare kishte numër shumë
9 të vogël. Pra, në atë kohë ne kërkonim të fitonim kohë, në
10 mënyrë që të fillonim të krijojmë, të kishim burimet e
11 nevojshme dhe të arrinim të kishim forcën bindëse, pra, që të
12 mund të ndihmonim popullsinë, popullin që të kuptonim ku ishin
13 interesat e tyre.

14 Ishte shumë frustuese për administratorët rajonalë që
15 ishin në dijeni të këtyre raporteve, por që njëkohësisht të
16 mos kishin ndonjë mundësi për të vepruar ndaj tyre, për t'ju
17 dhënë një përgjigje. Pra dhe motivimi apo morali ishte sfidë
18 në atë kohë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A morët vesh ndonjëherë, a
20 zbuluat ndonjëherë se kush i bënte këto mbledhje të taksave të
21 paligjshme, zhvatjet apo që mbante seanca informative, takime
22 informative?

23 PË. Unë personalisht, jo, nuk e zbulova. A u morr vesh në
24 ndonjë nivel tjetër? Ndoshta. Por në të njëjtën mënyrë, siç e
25 pamë në një dokument të mëparshëm që e pamë sot, vetë

1 paaftësia e KFOR-it për të përcaktuar nëse këto veprime ishin
2 veprime kriminale nga një strukturë vendore që i ngjante
3 mafies, apo diçka që lidhej ndonjë pjesë të UÇK-së aktive në
4 atë zonë, apo nëse ishte më e centralizuar, pra, e kontrolluar
5 nga qendra. Po sigurisht që në këtë pikë të procesit ne nuk
6 mund të kishim përgjigjet për këto pyetje dhe ishim shumë të
7 frustruar që nuk mund të jepnim një përgjigje.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet se gjatë
9 darkës që dhe ju z. Kouchner dhe z. Thaçi keni patur, keni
10 bërë me 18 korrik 1999, z. Kouchner, në fakt, e ngriti këtë
11 pikë, këtë problem me z. Thaçi? Ju kujtohet kjo?
12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kemi të dhëna me këtë dhe
14 që të shkojmë sa më shpejt, kjo është në provën materiale
15 P1980. Z. Kouchner është regjistruar këtu që i ka thënë z.
16 Thaçi se:

17 "Disa nga veprimet aktuale të UÇK-së nuk ndihmojnë në
18 këtë gjë, pra, siç janë 'ministrat e qeverisë' që nxjerrin
19 'dekrete' me 'vula zyrtare'.

20 Dhe pastaj duke iu referuar, pra:

21 "Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1244 -- dhe pastaj
22 duke iu referuar kësaj Rezolute kishin përcaktuar shumë qartë
23 se UNMIK-u se do ta administronte Kosovën gjatë periudhës së
24 përkohshme apo tranzitore."

25 Ju kujtohet që z. Kouchner i tha këtë z. Thaçi atë

1 mbrëmje?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet përgjigja e
4 z. Thaçi për këto kërkesa që kishte z. Koucher?
5 PË. Në përgjithësi, po. Në shembullin e parë ai dukej se
6 synonte të legjitimonte pretendimet e Qeverisë së Përkohshme
7 të Kosovës për të administruar Kosovën, që ishte në
8 kundërthënie të plotë dhe të drejtpërdrejtë me mandatin e
9 dhënë nga Këshilli i Sigurimit.

10 Ai, mesa më kujtohet, nuk dha ndonjë shenjë që do të
11 shkonte dhe do t'i udhëzonte njerëzit që të silleshin ndryshe.
12 Nuk dukej që ishte pjesa kryesore e përgjigjes së tij, pra.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A dha ai ndonjë shenjë,
14 apo kishte ndonjë tregues që ai do të respektonte, do të
15 përmbushte kërkesat e z. Kouchner, të cilat unë i kuptoj që
16 ishin -- kërkesat ishin, pra, që këto veprime binin në
17 kundërshtim me Rezolutën 1244?

18 PË. Nuk do përpiqem që ta citoj atë, por përgjigja e tij e
19 përgjithshme, mesa më kujtohet, ka qenë që -- në vija të
20 përgjithshme ka qenë: Në rregull, do të bëj atë që kam mundësi
21 të bëj. Një lloj përgjigje pak sikur zhvishej nga përgjegjësia
22 dhe nuk ishte -- shprehte një lloj mosdakordësie.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do i kërkoj
24 Sekretares që të sjellë, të shfaqë në ekran një dokument
25 tjetër.

1 Z. Covey, do t'ju jap pak kohë që të shihni dokumentin.
2 Fillimisht do t'ju pyes nëse e keni parë këtë ligj në librin e
3 taksat e akcizës dhe taksën e shifrës së qarkullimit.

4 PË. Në rregull.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kishit parë këtë më
6 parë?

7 PË. Nuk besoj ta kem parë më parë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po e shohim bashkë. Pra,
9 kjo pretendohet, pra, të jetë një listë që ka të bëjë për
10 akcizën dhe qarkullimin, taksën për akcizën dhe qarkullimin.
11 Mban datën 15 korrik 1999, Qeveria e Përkohshme e Kosovës,
12 Ministria e Financave, Prishtinë. Mban vulën, ka një vulë
13 zyrtare, Ministri i Financave, në anën e djathtë. Dhe thuhet:

14 "Në bazë të nenit 13 alineja 1 e Rregullores për Punën e
15 Qeverisë së Përkohshme të Kosovë, Qeveria e Përkohshme e
16 Kosovës nxjerr dispozitat e përgjithshme:"

17 Shpjegon qëllimin, pra:

18 "Me këtë dekret ligji rregullohet tatimi i akcizave dhe
19 tatimit në qarkullim të mallrave dhe shërbimeve, si dhe mënyra
20 e llogaritjes dhe afati i pagesës të këtyre lloj tatimeve."

21 E shikoni këtë?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta po ju pyes diçka
24 që është e qartë tashmë, po në atë kohë Rezoluta 1244 ishte në
25 fuqi?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe UNMIK-u vepronte në
3 terren.

4 PË. Në mënyrë të zbehtë. Ishin ditët e para kur kishim
5 arritur.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen
7 7 të këtij dokumenti, i cili mban numrin ERN 039414. E shihni
8 pjesën ku flitet në pjesën V, ku flitet për masat ndëshkimore?
9 Merrni pak kohë që ta lexoni.

10 Pyetje ime e parë: Mesa keni kuptuar ju dhe e keni
11 interpretuar ju Rezolutën 1244, Qeveria e Përkohshme, e
12 ashtuquajtura Qeveria e Përkohshme e Kosovës e kishte
13 autoritetin, pushtetin që të impononte dhe të mblidhte taksa
14 dhe që të miratonte të ashtuquajturat masa ndëshkimore të
15 cilat nuk respektonin rregullat?

16 PË. Jo, është mënyra se si e kemi kuptuar mandatin. Kjo --
17 mandati ishte, pra, kishte autoritet të përgjithshëm dhe të
18 tërësishëm mbi të ashtuquajturën Qeveri të Përkohshme të
19 Kosovës. Pra, asnjë prej këtyre nuk do të kishte patur vlerë
20 ligjore.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë tani në faqen e
22 fundit të dokumentit, në fund të faqes. Edhe në shqip.

23 Siç mund ta shihni këtu, ky dokument është nënshkruar nga
24 Kryeministri Hashim Thaçi dhe mban vulën e Ministrisë së
25 Financave të Qeverisë së Përkohshme. Këtu thuhet:

1 "Ky dekretligj hyn në fuqi dhe aplikohet ditën e
2 dekretimit të tij nga Qeveria e Kosovës -- u dekretua nga
3 Qeveria e Përkohshme e Kosovës me datën 23 korrik 1999."
4 Tani, pyetje. Kjo është vetëm pasi ju ishit takuar me z.
5 Thaçi dhe z. Kouchner. E saktë?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Thaçi a ju informoi
8 juve apo z. Kouchner se ai kishte miratuar dhe nënshkruar në
9 emër të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës një rezolutë mbi
10 taksat?

11 PË. Nuk besoj ta ketë bërë. Sigurisht që jo. Nuk kam mësuar
12 një gjë të tillë. Në fakt nuk kam ditur për këtë dokument
13 konkret. A mund të bëj një pyetje lidhur me të?

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

15 PË. Ne prisnim që do të kishte një lloj konkurrence, një lloj
16 -- për terren, për kompetenca duke testuar UNMIK-un për të
17 parë nëse ishte në gjendje që ta bënte administrimin. Dhe nëse
18 Qeveria e Përkohshme do të fitonte, pra, dhe do të realizonte
19 ambiciet e veta. Historia është e stërmbushur me shembuj të
20 tillë. Ekzili i De Gaulle në Angli, përpjekja për
21 legjitimitet, pra, është --

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju ndaloj këtu, po që
23 ta kem të qartë unë, ju nuk morët vesh asnjëherë, nuk mësuat
24 që --

25 PË. Jo, jo, ne prisnim që do të kishte një lloj konkurrence

1 të vazhdueshme për të parë se kush do të konsiderohej legjitim
2 dhe kështu me radhë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa e kuptova dëshminë
4 tua j u i kishit thënë z. Thaçi para pesë ditësh se j u i
5 konsideronit veprimet e tilla si të padobishme, nuk ndihmonin.
6 A është e saktë?

7 PË. Kjo është e saktë, po çështje -- atë që përmenda më parë
8 Charle De Gaulle, -- z. Kouchner dhe unë ishim, pajtoheshim
9 plotësisht dhe ishim të dakordësuar, por z. Kouchner nuk
10 kishte si qasje apo metodë të tij për të dhënë ultimatume, për
11 të ndaluar në mënyrë të shpreh -- shprehimisht disa gjëra,
12 sjellja e tij, dhe këtu pajtohem edhe unë me të, ishte më
13 shumë që të zhbllokoheshin rrugët apo të mënjanoheshin qasjet
14 që ishin jokonstruktive dhe që të vazhdohej më tej drejt
15 rrugëve që ishin më të dobishme.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do kërkoj të shfaqim në
17 ekran SITF00012125. Faleminderit.

18 Z. Covey, do t'ju sqaroj pastaj pjesën për të cilën po
19 flasim. Ky është një prej atyre raporteve të aktivitetet --
20 raporteve javore të aktivitetit të OSBE-së. Ky këtu është i
21 datës 16 gusht 1999 dhe mbulon periudhën nga data 4 gusht
22 1999.

23 I kërkoj Sekretarit të kalojmë faqen SITF00012128.

24 Z. Covey, përqendrohuni j u lutem tek paragrafi i dytë
25 këtu, i cili fillon me fjalët "Në Rahovec ..." Dhe këtu thotë:

1 "Në Rahovec Departamenti për të Drejtat e Njeriut ka
2 pranuar raporte se romët janë thirrur dhe marrë në pyetje nga
3 pjesëtarë të UÇK-së; një letër dërguar komandantit të UÇK-së
4 është dërguar lidhur me këtë pikë."

5 Pyetja ime e parë është: A ju kujtohet në këtë periudhë,
6 pra, në fillim të muajit gusht apo gjatë verës, a ju kujtohet
7 të keni marrë informacione se disa njerëz kishin marrë
8 fletëthirrje dhe ishin mbajtur të ndaluar nga personat që
9 pretendonin të ishin të UÇK-së?
10 PË. Po, jam në dijeni. Kemi marrë raporte të tilla dhe nga
11 burime të ndryshme.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a ju kujtoj saktë që
13 ata nuk kishin autoritet ligjor, pushtet ligjore për të bërë
14 një gjë të tillë?

15 PË. E saktë.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E dini se bazuar në cilin
17 autoritet apo pushtet këta individë kanë arrestuar dhe mbajtur
18 në ndalim persona të ndryshëm?

19 PË. Nuk di të kenë patur ndonjë autoritet konkret. Ne kemi
20 supozuar në atë kohë që -- se këto veprime të marra në tërësi
21 mund të ishin, apo ishin të motivuara nga interesat e krimit
22 të organizuar, ndoshta nga ekstremistë të cilët ishin të
23 lidhur me UÇK-në. Ne nuk ishim në gjendje të -- kishte raporte
24 të shumta dhe ne nuk kishim një forcë hetuese. Ne, edhe policë
25 për të bërë patrulla kishim pak fare.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet letra i
2 është dërguar komandantit të UÇK-së lidhur me këtë?
3 PË. Nuk e di për çfarë bëhet fjalë. Por, duket të jetë një
4 dokument i brendshëm i OSBE-së. Nuk e di që -- nuk di e të
5 jetë dërguar apo shpërndarë UNMIK-ut, por nuk jam në dijeni,
6 nuk e kuptoj referencën në letrën e dërguar. Nga kush, kujt,
7 nuk e di.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kujtohet që z. Kouchner
9 vetë e ka ngritur këtë çështje me z. Thaçi në fund të korrikut
10 --

11 PË. Ngritur --

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- në 1999. Po?

13 PË. E ka ngritur në përgjithësi çështjen në përgjithësi, po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do të lexoj atë që
15 Kouchner pretendohet -- thuhet t'i ketë thënë Thaçit dhe kjo
16 është si në vijim:

17 "Komandanti i KFOR-it tha se ishte i shqetësuar se
18 elementë të policisë ushtarake me uniforma të zeza."

19 Po ndaloj këtu, z. Covey. Neve na është thënë në këtë
20 sallë gjyqi se "PU" shenja "PU" i referohet policisë
21 ushtarake. Dhe pastaj në vijim thuhet:

22 "Ai", pra, z. Kouchner "pyeti kush ishin ata. Ata nuk
23 kishin autoritet për të bërë arrestime. Ky ishte rrëmbim,
24 kidnapim, ai po humbiste gjithnjë e më shumë besimin dhe do të
25 detyrohej ndoshta të reagoje ndaj kësaj."

1 Dhe pastaj është shënuar se:

2 "Përgjigja e z. Thaçi ishte e vagullt dhe po i shmangej
3 pyetjes."

4 A ju kujtohet ky shkëmbim mes z. Kouchner dhe z. Thaçi?
5 PË. Nuk më kujtohet plotësisht qartë, por konfirmon, sipas
6 asaj që mendoj unë, përgjigjen e z. Thaçi lidhur me këtë
7 çështje. Faleminderit që më sqaruat se "PU" do të thotë polici
8 ushtarake. Ishte paraqitur edhe në diskutime të tjera dhe nuk
9 kisha kuptuar se për çfarë bëhet fjalë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kujtohet si ishte
11 përgjigja shmangëse, pra, e z. Thaçi në atë çast?

12 PË. Nuk më kujtohet konkretisht. Nuk mund ta citoj.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Kouchner a e pyeti, i
14 kërkoi z. Çeku të vepronte të bënte diçka sepse duket që nuk
15 ka -- ka shënime apo të dhëna për një gjë të tillë? A i kërkoi
16 z. Çeku që të veprojë lidhur me këtë, të marrë veprime?

17 PË. Nuk mendoj se z. Çeku -- më kujtoni pak datën, ju lutem,
18 sepse në gusht dhe duke vazhduar dhe vijuar në shtator ne nuk
19 kishim një komunikim me z. Çeku. Ai do të bëhej shefi i TMK-së
20 dhe kjo binte nën kompetencat dhe administrimin e UNMIK-ut.
21 Por derisa kjo ndodhi bashkëbiseduesit e tij ishin KFOR-i.
22 Pra, personat me të vepronte.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më korrigjoni nëse e kam
24 gabim po besoj se ka qenë data 27 korrik 1999.

25 PË. Në rregull.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më korrigjoni në qoftë se
2 e kam gabim.

3 Ajo që po them është që si çështje strukturore nuk besoj
4 ta kemi ngritur me z. Çeku. Nuk ishim tamam në kontakt me të
5 në atë kohë, në atë moment që po flasim.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet, në qoftë se
7 ju kujtohet, z. Çeku, apo z. Thaçi kanë bërë apo kanë thënë
8 diçka apo që do bënin diçka për t'ju përgjigjur komenteve të
9 z. Kouchner?

10 PË. Mesa më kujtohet kjo është -- ajo që më kujtohet në
11 përgjithësi, përgjigjet e Thaçit ishin që kërkonte kohë dhe
12 ishin të vagullta, jo të drejtpërdrejta dhe kjo na dha
13 ndjenjën që ai kishte -- përshtypjen që ai kishte pak ndikim,
14 por nuk donte, hezitonte ta pranonte një gjë të tillë, pra
15 ndikimin e tij të pakët.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të kërkoj të shfaqim në
17 ekran provën materiale P4107. Dhe të kalojmë në faqen tjetër.
18 Më duket se është e njëjta faqe, pra, faqja në vijim në të dy
19 gjuhët. Po.

20 Do t'ju jap një çast që të shikoni këtë dokument vetë, z.
21 Covey. Në anën e majtë është origjinali, dhe ky dokument
22 thuhet të jetë lëshuar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, nga
23 diçka që quhet Ministria e Rendit Publik. Së pari, a e dini ju
24 kush është ky ministri i të ashtuquajturës Ministri e Rendit
25 Publik në fund të gushtit 1999?

1 PË. Nuk e di. Kjo duket që të jetë dërguar nga Së dyti, i
2 KFOR-it, pra, pjesa e zbulimit të KFOR-it.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta trajtojmë këtë. Në
4 anën e djathtë kemi vulën e Ministrisë së Rendit Publik,
5 numrin, data 20 gusht 1999, dhe pretohet të jenë fletëthirrje
6 në lidhje me komunën e Klinës dhe i referohet një bisede
7 informative, gjë të cilën e pamë në një dokument, në qoftë se
8 ju kujtohet, pak më parë kur jua tregova.

9 Dhe tek pjesa "Vërejtje" thuhet:

10 "Mosrespektimi i fletëthirrjes nga personi për t'u
11 paraqitur, në rast të mosrespektimit të kësaj dhe mosbindjes,
12 Policia e Rendit, organet e Policisë së Rendit Publik janë të
13 detyruar ta sjellin personin përmes forcës në përputhje me
14 normat dhe rregullat ligjore."

15 Tani, duke supozuar për një çast që ky dokument, ai që
16 pretendon të jetë, z. Covey, Ministria e Rendit Publik në
17 gusht në fund të gushtit 1999, a ishte e autorizuar sipas
18 Rezolutës 1244, që të thirrte, dhe në qoftë se ishte e
19 nevojshme të mbante, të ndalonte një person të caktuar në
20 mënyrën siç është përshkruar këtu?

21 PË. Absolutisht që jo.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ishit i informuar ju në
23 atë kohë se këto lloj gjërash, njerëz që prezantoheshin si
24 përfaqësues të Qeverisë së Përkohshme të Kosovë nxirrnin
25 fletëthirrje, lëshonin fletëthirrje të tilla?

1 PË. Kemi dëgjuar për -- kemi dëgjuar raporte për ndalime,
2 personalisht nuk më kujtohen ndalimet që i atribuoheshin në
3 mënyrë konkrete kësaj ministrie dhe me këtë si shembull duket
4 që ky është shkruar në nivel të komunës, por ne nuk e njohnin,
5 nuk e pranonim autoritetin e Qeverisë së Përkohshme të
6 Kosovës, të ministrit apo ministrisë së saj në asnjë nivel.
7 Pra, nuk kishin autoritet për zbatuar dhe ekzekutuar
8 fletëthirrje të tilla.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Covey,
10 këto ishin pyetjet e mia. Faleminderit për durimin tuaj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
12 Gaynor.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Covey, ju kanë treguar një telegram që është i
15 bashkëngjitur provës materiale 4 ndaj deklaratës suaj, që
16 është një telegram i dërguar në Nju Jork dhe që është një
17 shënim i UNMIK-ut që ka të bëjë me takimin tuaj me z. Thaçi me
18 18 korrik 1999,

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe thuhet që:

21 "Me 18 korrik udhëheqësi i UÇK-së, Hashim Thaçi, ftoi
22 PSSP-në dhe Jock Covey që të marrin pjesë në një darkë
23 treorëshe në banesën e tij."

24 A të kujtohet kjo gjë?

25 PË. Po, dhe me formulimi duket paksa fatkeq për shkak të asaj

1 që kemi mësuar më vonë.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e keni trajtuar ju z.

3 Thaçi si udhëheqës të UÇK-së?

4 PË. Ky ishte titulli që mbante ai. Titull i cili dukej se
5 ishte një pretendim pa asnjë bazë.

6 Në fakt, ky është raporti i darkës, apo jo?

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po.

8 PY. Dhe Sekretari ynë ka qenë shumë i mirë, Axel Dittman, ka
9 qenë shumë i mirë. Në atë kohë nuk i kam kushtuar vëmendje të
10 madhe këtij titulli si udhëheqës i UÇK-së. Po t'i kisha
11 kushtuar vëmendje do t'i kisha vënë një titull tjetër.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në një tjetër provë
13 materiale që ndodhet në deklaratën tuaj, pra është numri 8,
14 dhe është artikulli i Shekullit dhe ka këto fjalë:

15 "Udhëheqësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës tha ditën e
16 shtunë se ai nuk ka asnjë përgjegjësi lidhur me vrasjen e 14
17 fermerëve serbë. Hashim Thaçi, udhëheqësi i UÇK-së dhe shefi i
18 Qeverisë së Përkohshme i dënoi këto."

19 Pra, shohim në këtë artikull të njëjtën shprehje,
20 "udhëheqësi i UÇK-së".

21 PË. Dhe bëhet fjalë pikërisht për këtë tension që ne po
22 përpiqeshim ta -- të cilit ne po përpiqeshim t'i jepnim
23 zgjidhje në kokën tonë, se pavarësisht pohimeve, a ishte ai
24 vërtetë nga pikëpamja praktike komandant, komandanti? Dhe pa u
25 përpjekur që ta hidhnim poshtë këtë në praninë e tij ne kemi

1 arritur në përfundimin që kjo bëhej fjalë për një pretendim
2 bosh.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju thatë sot në mëngjes që
4 "nuk keni patur lidhje drejtpërdrejtë me udhëheqësit e
5 lëvizjes së UÇK-së". A mund të na tregoni se kë nënkuptoni ju
6 kur thoni udhëheqësit e UÇK-së?

7 PË. Po, zotëri. Me këtë formulim unë e kam fjalën për
8 udhëheqësit e UÇK-së në terren, për komandantët në terren,
9 komandantët e zonave.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, "udhëheqës të lëvizjes
11 së UÇK-së", ju e keni fjalën për komandantët e zonave dhe
12 askënd tjetër?

13 PË. Në përgjithësi, po. Ju kërkoj ndjesë në atë kohë mbase i
14 kemi përdorur gjuhën paksa pa rezerva.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Unë i kthehem edhe një herë
16 termit që na keni treguar juve që ju si diplomat nuk keni
17 burime të tëra dhe duhet t'i jepni udhëzimet qeverive tuaja.
18 Këtë e kuptoj.

19 Po dua të sqaroj disa informacione për të cilin keni
20 pasur qasje. Gjatë kohës që ke qenë në Kosovë a ke pasur qasje
21 ndaj komunikatave të brendshme të UÇK-së të 1998-s dhe 1999-s,
22 të lëshuara nga komandantët e zonave, nga Shtabi i
23 Përgjithshëm, niveli i brigadës, niveli i batalionit?

24 PË. Nuk besoj që në atë fazë të hershme kemi patur këtë
25 informacion. Nuk besoj, nuk besoj.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, nuk e keni patur
2 asnjëherë këtë mundësi për t'i lexuar këto?

3 PË. Të brendshme?

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, të brendshme, të UÇK-së.

5 PË. Jo, nuk besoj.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Keni dhënë dëshmi këtu
7 lidhur me sulmet hakmarrëse ndaj serbëve. Nuk dua t'i kthehem
8 kësaj po dua të përqendrohem në lidhje me pretendimet e
9 krimeve të kryera ndaj personave të mbajtur të ndaluar nga
10 UÇK-ja në vitin 1998 dhe 1999.

11 Unë e kuptoj që ju keni pasur shumë punë në dorë për të
12 zbatuar Rezolutën 1244. Përqendrimi juaj ishte stabilizimi i
13 situatës, krijimi i institucioneve funksionale të qeverisjes,
14 dhe e kuptoj që ka qenë kohë mjaft e ngjeshur dhe e
15 ndërlikuar.

16 Por, a kam të drejtë ta kuptoj kur them që analizimi i
17 krimeve të kryera në qendër të paraburgimit të drejtuar nga
18 UÇK-ja nuk kanë qenë pjesë e punës suaj?

19 PË. Fjala e duhur këtu është "përqendrim". Sigurisht që ne
20 nuk e përjashtonim atë si pjesë të punës sonë, po ne mund të
21 përqendroheshim vetëm në disa gjëra në atë kohë, jo në çdo
22 gjë. Nuk kemi patur aparat hetimi, nuk kemi patur as aparat
23 administrativ që të mund t'i ndiqnim këto zhvillime.

24 Si koment, a mund të them që do të kisha dashur që të
25 ishim treguar më të kujdesshëm me përdorim e gjuhës. Këtu

1 bëhet fjalë për burgje të drejtuara apo të administruara nga
2 UÇK-ja. Nuk di nëse kjo bëhej fjalë UÇK-në si organizatë apo
3 një udhëheqës lokal pa autoritetin e tij apo një person, një
4 individ i cili, në fakt, e quante veten se i takonte, por i
5 atribuonte këtë UÇK-së.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A është e vërtetë që nuk
7 keni patur burimet për t'ju dhënë përgjigje këtyre pyetjeve
8 mjaft të rëndësishme që keni ngritur? Kështu është?

9 PË. Po, kjo është e saktë, nuk kemi patur burime për t'i
10 ndjekur këto deri në fund.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kaq kisha për juve.
12 Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
14 pyetje vijuese nga ZPS-ja? Jo, kërkoj ndjesë. E ka fjalën
15 pjesa e Mbrojtjes.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të bëjmë një pushim. Pushim
17 që të marr udhëzime nga klienti im.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

19 Dëshmitar, do të marrim një pushim të paparashikuar për
20 dhjetë minutash.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
23 pezullohet deri në orën 12.20.

24 --- Seanca ndërpritet në orën 12.11

25 --- Seanca rifillon në orën 12.21

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, të
2 sjellim dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic ka
5 disa pyetje pasuese që vijnë nga pyetjet që kanë bërë
6 Gjykatësit.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

8 Pyetje vijuese të mëtejshme nga z. Misetic:

9 PY. Z. Covey, kam dy a tre pyetje për t'ju bërë. Gjykatësi
10 Barthe, në faqe të transkriptit 44 deri në 45, ju pyeti përse
11 nuk i keni kontaktuar ata që kanë patur forcë dhe influencë. A
12 të kujtohet kjo pyetje?

13 PË. Po.

14 PY. A keni marrë pjesë në takimet e Komitetit të Përkohshëm
15 të Zbatimit?

16 PË. E keni fjalën për Këshillin e Përkohshëm Ekzekutiv?

17 PY. Po.

18 PË. Po, duhet të kem marrë pjesë, por nuk më kujtohet në
19 cilën kam marrë pjesë.

20 PY. Në këto takime a kanë marrë pjesë komandantët e zonave?

21 PË. Oh, e keni fjalën për takimet e Mike Jackson?

22 PY. Po.

23 PË. Kam marrë pjesë në disa, po. Është pyetja?

24 PY. A kanë marrë pjesë në komandantët e zonave në ato takime?

25 PY. Po përpiqem të më kujtohet pamja dhe nuk më kujtohet që

1 të kenë qenë atje.

2 PY. Dakord. Pra, nuk e dini nëse në takimet me Gjeneralin
3 Jackson në të cilat kanë marrë pjesë dhe ku kishte probleme të
4 cilat duheshin zgjidhur me komandantët e zonave mund të ishte
5 zhvilluar kjo brenda atij konteksti?

6 PË. Megjithatë, këto ishin takime që i thërriste Gjenerali
7 Jackson dhe ato kishin një qëllim të veçantë dhe qëllimi ishte
8 që të arrinin marrëveshjen angazhuese.

9 PY. A ka marrë pjesë në atë takim z. Thaçi?

10 PË. Nuk më kujtohet që të ketë marrë pjesë në takime përveç
11 atij të cilin e kam shpjeguar në hollësi, pra takimin e
12 fundit.

13 PY. Dhe kjo është një pyetje e ndërlikuar. Ju pyeti Gjykatësi
14 Gaynor, çfarë keni ditur për funksionimin e brendshëm të UÇK-
15 së, dhe pyetja ime vijuese është e ndërlikuar. Përse duhej që
16 komandantët e zonave të merrnin pjesë në takime si takimi i
17 fundit i këtij Komiteti të Zbatimit, përse ishte e domosdoshme
18 që të ishin ato të pranishëm? Çfarë çështjesh do të
19 diskutoheshin sipas informacionit që keni pasur ju?

20 PË. Ne, KFOR-i në atë kohë përballej me një afat pranë të
21 cilit do të duhej që të arrihej marrëveshja angazhuese dhe kjo
22 marrëveshje kërkonte një lloj konsensusi nga udhëheqësit e
23 lëvizjes së UÇK-së. Kështu që unë e pranova që ky ishte një
24 takim plenar në të cilin do të jepej konsensusi në një farë
25 mënyre dhe nuk i vura asnjë pikëpyetje këtij nocioni, pra

1 ishte një takim në të cilat duhet të miratonim.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

6 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ellis, a keni
8 pyetje?

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ZPS-ja a keni
11 pyetje?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Covey, do
14 të jeni i lumtur ta mësoni që keni përfunduar.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të bëj një koment të
16 fundit?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, sepse nuk
18 ka mundësi që ta ndjekim atë me pyetje pasuese. Kemi
19 përfunduar.

20 Faleminderit që erdhët me ne. Faleminderit që na treguat
21 mbi të gjitha, ju urojmë gjithë të mirat.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit për mundësinë që më
23 dhatë për të ofruar këtë shërbim.

24 [Dëshmitari largohet]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na kanë

1 mbetur ca minuta. Keni treguar se deshët të ndiqnit si palë
2 Mbrojtëse të na tregoni diçka që ka bëjë me planin e punës.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, desha t'ju tregoja pas
4 konsultimit me anëtarët e tjerë të palëve Mbrojtëse që nuk do
5 të jetë e mundur që ne të përfundojmë në datën 14, dhe për të
6 dërguar edhe mocionet e tjera që na duhet, dhe po kështu dhe
7 dosjen përfundimtare brenda datës 22 dhjetor. Pra, ne presim
8 që të bëjmë një kërkesë të përbashkët për ta shtyrë këtë afat.
9 Përpara se ta bëjmë këtë, do të thoja kemi folur me
10 Prokurorinë dhe do konsultohemi *inter partes* për të arritur
11 një marrëveshje përpara se të mund t'ju vijmë me kërkesën tonë
12 për këtë shtyrje afati.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dikush tjetër
14 don të thotë diçka?

15 Z. DIXON: [Përkthim] Një çështje që ka të bëjë me këto
16 afate kohore dhe doja të thoja që mbeten një numër apelesh të
17 cilat duhet të merren parasysh në kuadrin e provave të
18 përbashkëta dhe në kuadrin e asaj që do të pranohet

19 Dhe e kam fjalën për apelet që kanë të bëjnë lidhur me
20 analizën mjeko-ligjore, me përgjimet dhe me dëshmitarët e
21 rregullës 155. Desha t'i përmendja këto për të thënë që të
22 gjitha duhet të merren parasysh kur bëhet fjalë për afatin
23 kohor. Këto vendime do të dalin dhe do të ndikojnë mbi këtë
24 çështje në tërësi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Këtu përfundojmë seancën.

2 --- Seanca mbyllet në orën 12.29

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25